

## VASIL S. TOLE:

Nuk mendoj përmes një instrumenti, por përmes muzikës si e tërë. Ajo është instrumenti ideal


Bisedoi Andreas Dushi



Përmbledhja e poezisë së zgjedhur të Preç Zogajt,  
Në çdo pasqyrë na sheh mëkati (UET Press)

## Biografemat lirike si Ode, Litani dhe Ekloge Urbane

Nga Gëzim Basha



E shkruar me seriozitet maksimal, spiralja poetike e Zogajt vjen si sprovë sipërore estetike plot vitalitet kuptimor dhe elokuencë shprehëse për këdo që ka interes serioz mbi artin e poezisë. Poezitë e këtij vëllimi mbeten ndër arritjet më origjinale të poezisë shqipe në katër dekadat e fundit. (fq. 6)

Festivali letrar  
ndërkombëtar

për të rinj  
“Tirana Gate” 2024  
9-10-11 tetor

Nga Irena Toçi

(fq. 10)

### SHËNIME MBI LIBRAT

“Corriere della Sera” për botimin në Itali të romanit  
“Vera pa kthim” të Besnik Mustafajt

NJË MUAJ MJALTI  
I NGRIRË

Nga Marco Ostoni

(fq. 10)

Shënime për romanin “Gruaja në të zeza” të  
shkrimtarit Bedri Islami

REZISTENCA SHPIRTËRORE  
DHE LIRIA E FJALËS

Nga Namik Dokle

(fq. 12)

VËZHGIM MBI LIBRIN  
“PORTRETE PA KORNIZË”

TË TREGIMTARES  
AJKUNA DAKLI

Nga Flurans Ilia

(fq. 17)

Romani “Mossanga” i Fate Velajt

NJË ROMAN PËR  
KUJTESËN KOLEKTIVE

Nga Monika Stafa

(fq. 20)

GJURMIME STILISTIKE  
NË UDHËN E POETIT

AGIM BAJRAMI

Nga Kosta Nake

(fq. 21)

Katër tregimet e  
fundit të Kadaresë

Nga Ballsor Hoxha

(fq. 4)

In memoriam

Terezina Zorba,  
historia e saj me cigare  
dhe me lot

(fq. 15)

Identiteti dhe vitaliteti i  
Bienales Ndërkombëtare të  
Artit Bashkëkohor të Durrësit  
Nga Massimo Scaringella, Kurator

(fq. 19)



### BIBLIOTEKË

Florian Gantner

(fq. 22)

*Për aq sa dihet*

(Përktheu nga origjinali Ana Kove)

Clemens Myer

(fq. 23)

*Plaku varros kafshët e tij*

(Përktheu nga origjinali Ana Kove)

Xhevair Lleshi

(fq. 14)

*Murmurimat*

Anton Pappleka

(fq. 16)

*Një fije bari më tha*

Nuri Plaku

(fq. 18)

*Nusja e sarajit*

Nga Toena, me përkthimin e Milena Selimit

“Kohëstrehim” i Georgi  
Gospodinov, edhe në shqip

(fq. 20)

Arben Meksi fiton çmimin e dytë  
në Festivalin Ndërkombëtar të  
Karikaturës Ferizaj 2024

(fq. 13)

Rudolf Marku - rapsodi i  
emigrimit bashkëkohor

Nga Vangjush Ziko

(fq. 11)

**A.D.:** Meqë muzikën nuk e njoh në një nivel të atillë për të folur në terma studimorë, kjo bisedë do të orientohet, po të jeni edhe ju dakord, në diskutime mbi përvojën tuaj si kompozitor dhe zbërthimin e saj nëpërmjet përjetimeve të mia si dëgjues. Ndaj, krejt natyrshëm, e para pyetje që më vjen në mendje, lidhet me procesin e krijimit. Nëse në pikturë, një ngjyrë mund të rrijë vetëm në kontekste të caktuara apo në letërsi një fjalë edhe e vetme ka jetën e saj, po në muzikë, ku një notë e shkëputur nga të tjerat duket sikur nuk thotë diçka, si ja dilni ta ndërtoni strukturën aq komplekse dhe aq të ngjeshur të një partiture?

**V.T.:** Të krijosh muzikë është një proces që kalon nga metafizika drejt fizikes, pra nga çasti magjik, do të thosha, i idesë fillestare, që lind brenda teje si motiv muzikor i koncentruar, drejt një realiteti më fizik, më konkret, një realitet ku ka letër e pentagrame, ku ka rregull, formë, masë, ritëm, lëvizje, harmoni, tinguj të shtrirë në hapësirë dhe në kohë. Është si të ndjesh fizikisht mendimin dhe të tentosh të mendosh ftohtë ndjenjën. Me pak fjalë, një proces kompleks i cili pleks në vetvete disa fusha dijeje, nga ato muzikore, te shkencat humane, ato natyrore e teknike, si matematika e gjeometria, arkitektura dhe akustika etj. Ja, mendoje, e thënë thjesht është që duhet që të kapësh fillimisht diku motivin fillestar, ashtu si Tezeu në antikitet që kapi fillin e Arianës për të dalë nga labirinti ku ishte. Këtë "fill muzike", që tashmë e ke prekur edhe fizikisht, që e ke në dorë - si të thuash, duhet ta tërheqësh nëpër shtigjet e errëta të "labirintit krijues" deri sa të dalësh prej tij, në dritë. Prandaj në antikitet muzikën e konsideronin si arti më inteligjent, pasi kompleksiteti i gjërave me të cilat përballet kompozitori është i pafundmë.

Për të fiksuar zanafillën e këtij procesi unik kompozitorët kanë secili modelet e tyre, p.sh. Moxarti shënonte motivet ose temat sa herë që frymëzimi ia sillte. Mënyra se si i vinin motivet ende nuk dihet, por ai i shënonte ato për t'i përdorur më vonë në kompozimet e tij. Praktika që ai ndiqte u zbulua së fundmi, kur u gjet një bllok në të cilin Moxarti kishte shkruar shkurt e qartë motive të ndryshme në pentagram, së bashku me shënime të ndryshme me fjalë, që ky *motiv x* mund të vlejë për trio, kuartet, sonatë a simfoni. Nga kjo kuptojmë që pjesa fillestare është gati e pakapshme për këdo, e më pastaj, kur kompozimi zhvillohet, procesi ndodh më ngadalë dhe kompozitori merr kohën që i duhet për ta realizuar gjithë kompozimin që fillimisht vjen si shkreptimë rrufeje. Nga përvoja ime modeste kam parasysh se ideja zakonisht më vjen bashkë me një konceptim sado të përgjithshëm të strukturës, duke ma lehtësuar më pas procesin e kompozimit.

**A.D.:** Në një kompozim, sa e vështirë është përzgjedhja e tematikave dhe, mbi të gjitha, si mund të identifikohen se cilat janë tematikat e një simfonie?

**V.T.:** Trashëgimia e muzikës profesioniste na provon se ka dy lloje muzikash: me program dhe ajo pa program. Nuk më rezulton se ka tjetër lloj. Nëse i referohemi p.sh., gjinisë së simfonisë, është e lehtë për dëgjuesit në rastet kur simfonitë janë me program (të plotë apo qoftë edhe përmes titujve orientues), siç përmendëm më sipër edhe simfoninë e pambaruar "Dy lule mbi vorr të Skënderbeut" të At Martin Gjokës, apo "Simfoninë pastorale" të Beethovenit, apo "Simfoninë Alpine" të Edmond Buharasë etj., të cilat të fokusojnë qysh në titull në sferën e interesave që synojnë të

# VASIL S. TOLE

## Nuk mendoj përmes një instrumenti, por përmes muzikës si e tërë. Ajo është instrumenti ideal

Bisedoi: *Andreas Dushi*

pasqyrojnë. Është disi më e vështirë në dukje të parë, kur simfonia apo vepra muzikore është thjesht muzikë e pastër, pa titull, p.sh. simfonia nr. 1, 2, 3... apo koncert për violinë dhe orkestër etj. Në këtë rast, nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, e kam fjalën për publikun që kërkon shpjegime, pasi ata duhet të dinë që muzika komunikon përmes gjendjeve emocionale që përcjell dhe jo ndryshe, as përmes fakteve a narrativës së fjalëve. Pra, nëse gjatë dëgjimit të muzikës ju bëheni pjesë e saj duke përjetuar në mënyrën tuaj gjendjet dhe emocionet që kompozitori ka dashur të përcjellë, jeni në vendin dhe në kohën e duhur.

**A.D.:** Dhe, meqë jemi te simfonia, një zhanër relativisht i vonë në muzikë: Cili është udhëtimi i saj në Shqipëri? Kur fillon, kush e lëvtron më së pari...?

**V.T.:** Muzika jonë e kultivuar ka një traditë që lidhet me Shkodrën e fundit të shek. XIX, kryesisht në fushën e muzikës urbane, shfaqur si krijimtari për formacionet e orkestrave frymore, ose bandat muzikore, me emra krijuesish si Palok Kurti (1858-1920), Frano Ndoja (1887-1923) etj. Pra, një traditë relativisht e re. I pari kompozitor profesionist mbahet Lec Kurti (1884-1948), i biri i Palok Kurtit, i cili u shkollua për kompozim në Itali në vitet 1909-1915, por që nuk e vazhdoi atë më pas. Përgjithësisht, tradita e re e muzikës që po krijohet në Shqipëri ishte e lidhur me trashëgiminë muzikore popullore vendëse dhe me një ndikim të kuptueshëm nga muzika italiane, që kishte të bënte edhe me peshën pozitive të Kishës Katolike në jetën muzikore të Shkodrës së atyre viteve e sidomos në formimin muzikor të shumë të rinjve, të cilët u bënë më pas personalitete të muzikës sonë, si Česk Zadeja, Tish Daija, Tonin Harapi, Simon Gjoni, Pjetër Gaci etj. Ishte At Martin Gjoka (1890-1940) ai që, përmes krijimtarisë së tij muzikore, solli në muzikën tonë konceptin e simfonizmit si zhvillim dramatik muzikor, të simfonisë si gjini dhe të orkestrës simfonike si e tillë, pasi simfonia shkruhet për formacionin e orkestrës simfonike. Duhet theksuar fakti që nëse opera ka një origjinë të qartë italiane, simfonia si gjini është e lidhur me traditën e madhe muzikore austro-gjermane, me emra të mëdhenj si Hajdeni, Moxarti e më pas

Bethoven, Brahms, Shubert etj. At Martini i përkiste kësaj tradite. Ai ishte shkolluar për teologji e muzikë në Salzburg dhe formimin e tij muzikor profesionist e vuri në shërbim të hedhjes së bazave të simfonizmit shqiptar në muzikë. Vepra e tij simfonike "Dy lule mbi vorr të Skënderbeut" (1922), konsiderohet si e para simfoni e pambaruar në muzikën tonë. Aty gjejmë rrënjët e simfonizmit tonë kombëtar e, po ashtu, një koncept të qartë të zhvillimit simfonik, aq të domosdoshëm për një muzikë që synonte profesionalizmin. Ai shkroi edhe vepra të tjera, por kjo vepër është një nga gurët e themelit të muzikës sonë profesioniste. Vetëm dy vjet pas përpjekjes së At Martinit për të shkruar muzikë simfonike, tanimë në Korçë, dirigjenti dhe kompozitori shqiptaro-amerikan Thoma Nassi formoi dhe dha koncertin e parë të një orkestre simfonike modeste në Shqipëri. Ishte data 6 prill 1924, për të cilën nuk po zgjatim këtu.

Në vitet 1930 Migjeni shkroi një poezi me titullin "Lutje", një lutje e cila i drejtohej Zotit për një simfoni, e jo për diçka tjetër siç dimë që bëhen zakonisht lutjet, lutje që u dëgjua dy dhjetëvjeçarë më vonë, kur shkodrani tjetër, kompozitori më i shquar shqiptar Česk Zadeja (1927-1997), kompozoi të parën simfoni të vërtetë, shqiptare e europiane. Ishte viti 1956 kur u përmbush lutja e Migjenit!

"Lutje"  
Të lutem, o perëndi,  
për një simfoni  
me tinguj t'argjantë  
e akorde t'artë.  
Të lutem, o perëndi,  
për një simfoni  
plot dashuni  
të nxehtë si te vasha gjithë  
kur vlojnë ndijesitë.  
Të lutem, o perëndi  
për një simfoni  
të dëfret në lumni  
t'u u përkundë n'ani  
të bukur t'andrrimeve  
të kaltër, ku të fantazmëve  
buzët më tërheqin zjarrrtë  
e më digjen syt e flaktë.  
Të lutem, o perëndi,  
për një simfoni  
e kurr, e kurr ma mos të zgjohemi.




**A.D.:** Çfarë ndikimi kanë format e tjera të artit në procesin tuaj të kompozimit?

**V.T.:** Këtë e shoh në dy aspekte. Së pari, si nevojë që një krijues ka për të njohur e ditur zhvillimet në artet simotra (letërsi, arte pamore, teatër e balet), dhe aspekti tjetër lidhet me "ngacmimet" krijuese që të vijnë prej veprave a subjekteve që trajton kryesisht letërsia, por dhe artet e tjera dhe jo vetëm kaq. Sa i përket aspektit të parë, sjell në vëmendje që krijuesi ideal është ai që përshfaqet në të gjitha llojet e arteve. Rilindja italiane solli disa modele të tilla që kulmojnë me poliartistin Leonardo da Vinçi, që ishte piktor, skulptor, arkitekt, shpikës, shkrimtar e deri kompozitor etj. At Fan S. Noli ynë ishte i këtij kalibri. Vetë kam synuar që të kem një raport të qëndrueshëm në njohjen e arteve simotra. Jam një lexues i mirë i letërsisë dhe ndjek me shumë kërsheeri artet pamore në botë dhe në vend. Ndoshta për këtë ka ndikuar babai im Sofokliu, i cili ishte mësues muzike dhe vizatimi, ish-nxënës i Jordan Misjes (1911-1942) dhe i Zef Kolombit (1907-1949) në *Normalen* e Elbasanit, shok klase me Fatmir Haxhiun (1927-2001) në "Shkollën e Kuqe" në Tiranë.

Sa i përket ndikimit nga format e tjera të artit, dihet botërisht se janë shumë vepra muzikore me program që janë mbështetur në tema dhe subjekte të mëdha që i ka trajtuar p.sh. letërsia, e që janë shndërruar në kryevepra edhe në muzikë. Po përmend këtu uverturën "Egmont" të Beethovenit mbi tekstin e Gëtes, baletin "Romeo dhe Zhuljeta" të Prokofievit mbështetur mbi tragjedinë e Shekspirit, baleti "Para stuhisë" i Česk Zadejës i mbështetur mbi romanin "Lumi i vdekur" i Jakov Xoxës, "Britma" e Thomas Simakut mbështetur në pikturën "The scream - Britma", për orkestër etj.

Në krijimtarinë time po sjell dy vepra, që të dyja opera të mbështetura në vepra të mëdha të letërsisë botërore dhe asaj kombëtare. Në vitet 2000 shkrova operën "Eumenides" mbështetur në tragjedinë e Eskilit me të njëjtin titull, përkthimi në shqip nga Ismail Kadare, premiera në Athinë (tetor 2005); dhe operën tjetër "Gjergj Kastrioti Skënderbeu - Kryezot i Arbërit" (2023), mbështetur në veprën letrare të Imzot Fan S. Nolit me të njëjtin titull, premiera në Tiranë dhe në Prishtinë (maj 2023).



Skano për të parë dhe dëgjuar operan "Eumenidet".



Skano për të parë dhe dëgjuar operan "Skënderbeu Kryezot i Arbërit".

**A.D.: Po teknikat muzikore si ndikojnë në të tjera forma të artit? Kam parasysh, për shembull, librin tuaj studimor "Kadare dhe muzika"...**

V.T.: Meqë përmendët Kadarenë e madh dhe të paharruar, dëshiroj të kujtoj se ai ka folur më se një herë për rëndësinë që teknikat kanë për krijuesin, e po ashtu edhe për shkrimtarin. Ka theksuar se "për shkrimtarin zbulimi i teknikave të reja të shkruarit është një nga mundimet që mund të krahasohet me ato të Tantalit. Në pamjen e parë të duket se nuk është e vështirë të zbulosh teknika te reja. Mirëpo pikërisht këtu nis diçka e habitshme, një forcë mizore, ndaluese, e ngjashme me tërheqjen e tokës, që nuk të lë të shkosh më lart. Kjo më shumë se me ty ka lidhje me tërë botën, me mekanizmin e shijes së krijuar prej shekujve, falë të cilit njerëzimi arrin të marrë kumtin tënd". Ky mekanizëm "shijeje" që thotë Kadare, nuk është gjë tjetër përveçse njohuria e deriatëhershme e cila, më së pari, duhet njohur e ditur, në mënyrë që më pas të mundesh ta tejkalosh duke ndërtuar mbi të diçka të re, e që të përket vetëm ty. E reja lidhet pikërisht me teknikat e përdorura.

Në krijimtarinë time të lidhur ngushtë me rrënjët etnike të muzikës sonë popullore, kam zbatuar disa teknika të veçanta të lidhura ngushtë me procesin tim krijues, si "cluster iso", "polifoni e fshehur", "polipentatonitë e ngrira", "fraktus kabaja" etj. Ndër veprat ku janë përdorur këto teknika përmend "Avaz II"-1994, "Dda"-1994, "Genotip"-1996, "Trias"-1996, "A psalmodiae Bono"-1999, "Iso polyphony multiverse"-2015, "Ep"-2017, "Polifoniso"-2021, "Violin Concert"-2023 etj.

Kthehemi te Kadareja. Ai e dinte së brendshmi se vepra e tij kishte një lidhje të pandarë me muzikën. E kishte dëshmuar këtë me romane që i quante «Roman me iso» (për "Dimrin e vetmisë së madhe", apo "Koncert në fund të dimrit"), pa sjellë shembuj të tjerë të shumtë në veprën e tij në të cilën nuk gjen të përdorur gabimisht asnjë gjë që lidhet me muzikën, apo qoftë kjo terminologji të saj.

Për herë të parë shkrova për këtë subjekt në librin "Muzika dhe letërsia", Onufri, 1997. Një nga kapitujt quhej "Projekt për një guidë muzikore nga vepra letrare e Ismail Kadaresë", ku u mora kryesisht me prezencën e dukshme të lëndës muzikore të përdorur në veprën e tij letrare. Më pas erdhi natyrshëm "Kadare dhe muzika" (2019), studim për të cilin akademiku Shaban Sinani thotë se "ky libër është një prej atyre veprave që e bëjnë njeriun të kuptojë se sa i varfër do të ishte leximi i veprës letrare vetëm si art fjale. Në të kundërtën, leximet ndryshe, prej pikëvështrimesh nga jashtë letërsisë, provojnë se sa lehtësisht të rrëzueshëm janë kufijtë që projektojnë historia e letërsisë, teoria, kanonet, vetëmjaftueshmëria e tekstit".

Vetë Kadare nuk u surprizua kur u njoh me librin. Pak kohë pas botimit të tij, në një intervistë ai pohoi: ... *më është hapur nami*



që Kadareja nuk e do muzikën. Nuk është hiç fare e vërtetë. Në mënyrën time të shkruarit, e kam ditur intuitivisht, por ma kanë thënë specialistë të muzikës që, përdor shpesh atë zhdrivillim, që quhet, atë procedim që përdor muzika, me lajtmotivet që shfaqen, që zbehen, që ridalin, që ulen, që ngrihen. Siç duket është një dukuri tautologjike e artit, te të gjitha artet". E dija që opinioni i tij lidhej me librin tim, opinion të cilin e kisha pritur të bëhej. E shkrova librin "Kadare dhe muzika" se mendoja dhe mendoj që artet janë të ndërlydhura me njëra-tjetrën dhe se krijuesi ideal është ai që i zotëron në mënyrën e tij që të gjitha artet. Kadare ishte një i tillë.



Skano për të parë librin "Kadare dhe muzika" dhe artikujt e shkruar për të.

**A.D.: Kur e mendoni një pjesë muzikore, keni në mendje një instrument të caktuar? Shkrimtarëve dygjuhësh u bëhet pyetja se në ç'gjuhë mendojnë. Po ju, me çfarë instrumenti mendoni?**

V.T.: Vështirë të heqësh një paralele mes tyre, pra mendimit muzikor dhe gjuhëve te shkrimtarët dygjuhësh. Kam njohur nga afër një shkrimtar të madh dy e tregjuhësh, më pas vepra e tij u përkthye në mbi 30 gjuhë të botës. E kam fjalën për mikun tim të ndjerë, shkrimtarin dhe akademikun Luan Starova, shqiptar me origjinë nga Starova e Pogradecit, por që gjithë jetën e tij e kaloi në Maqedoninë e Veriut. Për shkak të rrethanave, ai e shkroi veprën e tij letrare në gjuhën maqedonase dhe atë franceze, edhe pse e mendonte në shqip atë. Ai vetë ka thënë se dhe kur shkruante në gjuhë të tjera, veprat e tij frymëmarrjen e kanë shqip! Vitet e fundit të jetës ia kushtoi botimit të veprës në gjuhën shqipe, duke e derdhur atë brenda trupit të gjuhës sonë. Për të ishte si një rikthim te rrënjët. Ishte shumë i ngazëllyer

nga ky proces. I dukej se po kthehej më në fund në shtëpi pas një largimi të gjatë. Ndër kryeveprat do të përmendja romanet "Migrimi i ngjalave", "Koha e dhive" si dhe romani i fundit "Polifonistët", për të cilin në shumë aspekte kam qenë afër tij për t'i treguar mënyrat se si funksionon polifonia me iso. Ishte shumë i interesuar t'i dëgjonte edhe prej meje. Sa i përket kompozitorit, në këtë rast unë, nuk mendoj përmes një instrumenti, por përmes muzikës si e tërë, ajo është instrumenti ideal. Po, ka një instrument kur mendon përmes tij, por kjo ndodh kur vepra mendohet të shkruhet për atë instrument.

**A.D.:** Në vijim të pyetjes së mëparshme, mund të flasim pak edhe për procesin e orkestrimit?

V.T.: Është pyetje shumë teknike për të dhënë një përgjigje të kuptueshme për të gjithë. Ajo që mund të them për orkestrimin është e lidhur me bërjen të mundur që çdo instrument në orkestër të vendoset në një rend gjërash ku të ruhet individualiteti i çdo instrumenti (kam parasysh respektimin e të dhënave teknike të veglës - shënimi im V.S.T.), raporti i kësaj vegle me të ngjashmet brenda familjes dhe përtej kësaj, me të tjerat jashtë familjes së instrumenteve. Se edhe instrumentet kanë familjet e tyre. Pra, në funksion të muzikës, të gjitha instrumentet vendosen në ekuacione e raporte muzikore tingullore që shtojnë ngjyrat dhe larinë e përdorimit në orkestër. Vetë orkestra është si shoqëria. Ajo përbëhet nga individë që kanë zërin e përveçëm, që mund të unifikohen në një zë të përbashkët, ose që ndahen në grupe të ndryshme, të cilat përsëri duhen të ruajnë tiparet e tyre dhe të tingëllojnë së bashku. Partitura ka të paktën mbi 20 lloje instrumentesh dhe që ato të kenë kuptim duhet të bashkëtingëllojnë, në çdo formë. Të gjitha këto i kam parasysh kur orkestroj.

**A.D.: A vlerësohet mjaftueshëm tradita e kompozitorëve shqiptarë apo njëlloj si në letërsi, apo kinematografi, publiku është më i prirë drejt së huajës që, prej vitesh tanimë nuk përfaqëson më të panjohurën?**

V.T.: Nuk mund të them që vlerësohet, pa thënë që nënvlerësohet me qëllim. Shpesh këtë krijimtari e mbulon heshtja, ose zgjohet interesi për të kur rrallë, fare rrallë, në përvjetorë krijuesish të shquar organizohen koncerte, apo kur për nevoja ngjarjesh të mëdha ftohen kompozitorët

në konkurse të caktuara. Duke filluar që nga shkolla ku përgatiten kompozitorët, ka një rënie të numrit të të interesuarve për të studiuar kompozicionin e, po ashtu, pak kompozitorë aktivë nuk gjejnë mundësi për t'u mbështetur përmes programeve shtetërore për nxitjen e krijimtarisë së re në gjinitë madhore të muzikës, pa folur që nuk ka as çmime kombëtare në muzikë, ashtu siç ka për artet e tjera. Kjo shpjegon faktin që pas viteve 1990 numërohen me gishtat e dorës veprat e mëdha skenike apo simfonike, ky "mecenatizëm shtetëror" nuk e ka luajtur rolin e tij për ta mbështetur këtë krijimtari përmes stimulimit të krijuesve të saj. Në këtë aspekt kanë mbetur pa u përmbushur disa detyrime thelbësore që parashikon ligji nr. 10352 "Për artin dhe kulturën", kreu VIII "Tarifat e shpërblimit të cilësisë artistike", neni 34 "Masa dhe kriteret e shpërblimit", ku thuhet:

1. Masa e shpërblimit të gjinive artistike, sipas fushave të artit dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, në zbatim të politikave të saj, organizon konkurse kombëtare dhe skema të tjera vlerësimi në gjini të ndryshme të artit. Kushtet dhe masa e shpërblimit të fituesit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën."

3. Kushtet, kriteret dhe masa e shpërblimit për rezultate të larta, të arritura në konkurrime ndërkombëtare për artin e kulturën, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pa përmbushjen e këtyre detyrimeve përmes VKM-ve përkatëse, mbështetja për krijimtarinë nuk ka si të realizohet dhe kësaj shndërrohet në utopi! Ndërkohë, dua të pohoj se publiku shqiptar dhe ai i huaj e ka mirëpritur dhe e mirëpret muzikën tonë kur ajo interpretohet, si brenda vendit dhe jashtë tij. Ka me dhjetëra artikujt e komente pozitive për të, qoftë për muzikën e madhe të traditës, por edhe për muzikën pas viteve 1990 dhe autorët kryesorë të saj. Siç e përmenda, problem mbeten gjinitë e mëdha dhe subvencionimi për vepra të reja!

**A.D.: Ju frikëson ideja se mos shoqëria e njësion kulturën me kureshtinë e, mandej, me argëtimin dhe kështu, ajo, kultura, pra, zëvendësohet me aktivitete zbatimëse?**





Përmbledhja e poezisë së zgjedhur të Preç Zogajt,  
Në Çdo Pasqyrë na Sheh Mëkati (UET Press)

# Biografemat lirike si Ode, Litani dhe Ekloge Urbane

Nga Gëzim Basha



Përmbledhja e poezisë së zgjedhur të Preç Zogajt, *Në Çdo Pasqyrë na Sheh Mëkati* - një kaskadë gjuhësore mahnitëse dhe manifestim i plotë i maturisë estetike - konfirmon jo vetëm vendin e autorit në hierarkinë kanonike të poezisë shqipe, por edhe kapacitetin e sotëm të shqipes për ta mbërrirë sublimimin poetik me spontanitet fluid. Them kapacitetin e sotëm të shqipes, me drojën se mos vulgu pseudokulturor i epokës digjitale, i aftë vetëm për ta shfytëruar këtë cilësi, e kthen shqipen e së nesërme nga një gjuhë e vdirë në një gjuhë të vdarë...

E shkruar me seriozitet maksimal, spiralja poetike e Zogajt vjen si sprovë sipërore estetike plot vitalitet kuptimor dhe elokuencë shprehëse për këdo që ka interes serioz mbi artin e poezisë. Poezitë e këtij vëllimi mbeten ndër arritjet më origjinale të poezisë shqipe në katër dekadat e fundit. Ato janë performanca dhe akte magjike, në të cilat përfytyrimet e lira konvertohen në realitete me furi të brendshme, i imponohen hierarkisë, por pa impozime.

Përmendja e hierarkisë kanonike në poezinë shqipe më duket me vend për dy arsye: e para teorike, e dyta më praktike.

Globalisht, në studimet letrare dhe debatet akademike të dekadave të fundit, veçanërisht pas publikimit të Kanonit Perëndimor nga Harold Bloom, ka pasur një reaktion anti-kanon, një tendencë për t'i relativizuar vlerat estetike në favor të politikave kulturore që fitojnë vëmendje duke e shpërfillur hierarkinë. Ky është shkaku pse Bloom, për të mbrojtur pozitën e vet, shprehet, "një kritik nuk mund të jetë profet e, megjithatë, konceptimi im për kritikën (letrare) e përfshin kanonbërjen, një gjë jo aq popullore së voni."<sup>1</sup>

Së dyti, nga një shtysë më praktike, por që reflekton klimën tonë letrare: kur përpjekjet për sanksionim të Kanonit letrar nuk janë popullore në ShBA, konsideroni Shqipërinë e sotme, ku çdo përpjekje për të përvijuar hierarkinë letrare provokon një kakofoni agresive reagimesh, të cilat të kujtojnë shpërthimin e Mujit në epos, "shtatëqind vjet do t'i shemb kullat..." Harrohet se hierarkia letrare nuk është rezultante e pasionit për vetëpromovim dhe as e promovimeve përmes grupimesh, shpesh, (anti)kulturore; hierarkia është konsensus që përftohet përmes argumentimit dhe synon ikjen prej kaosit.

Kjo parathënie është edhe përpjekje modeste në këtë kah. Një Kaos-Mos!

## II

Prej debutimeve të para te përmbledhja më e fundit, Preç Zogaj, pavarësisht respektit të shprehur ndaj traditës, e ka shkruar poezinë me termat e veta. Modelet e poezive të tij u afirmuan si hibride komplekse varietetesh formale dhe epifanish kuptimore, përherë duke ushtruar një sintaksë elastike dhe elegante, e aftë për të thënë gjithçka me një balancë të përkorë. Me përkujdesjen e tij për diksionin (me diksion nuk kam parasysh tonin, por përzgjedhjen e fjalëve) dhe sintaksën poetike, krijimtaria poetike e Zogajt të kujton përkufizimin e njohur të Coleridge- it për poezinë si "vendosje e fjalëve të duhura në rendin e duhur". Gjuha e bukur mbetet synim i përhershëm i Zogajt, ngaqë ai e konsideron poezinë art evokativ me ndikim imediat mbi mendjen dhe shqisat.

Ndjeshmëria e tij gjuhësore e mban poezinë si një formë të butë hipnoze, e aftë të tërheqë vëmendjen dhe të temperojë kujtesë. "Poezia", thotë poeti dhe kritiku amerikan, Dana Gioia, "e përdor (qëllimshëm) ëndjen estetike si formë instruktimi, ka forcë magjike dhe ushtron efekte të forta. Kujtoni Orfeun, këngët e tij mund të ndryshojnë realitetin duke krijuar komunitete"<sup>2</sup>. Poezia lirike e Zogajt - ngjashëm me konceptin e Gioia-s - i reflekton përndritjet e saj të brendshme me vibrime kuptimore, të afta për ta vënë në punë (vë)mendjen e lexuesit.

Lirizmi i lindur dhe përkujdesja gjuhësore e kultivuar bëjnë që në vargun e Zogajt edhe gjërat më të zakonshme, kaluar në një filtër lirik defamiliarizimi, të krijojnë një festë letrare të pazakontë, larg tonit deklarativ, angazhimit të drejtpërdrejtë dhe "erudicionit" skolare.

Magjika dhe logjika kontaktojnë përtej sipërfaqes së dukshme; mënyra se si poezitë e Zogajt e bëjnë kuptimin e tyre, jo rastësisht, përkon me përkufizimin e nobelistit meksikan Octavio Paz, "poezia është këngë dhe kënga nuk është as diskurs dhe as shpjegim"<sup>3</sup>. Për të shkrimi i poezisë nuk është as akt i lehtë, as krijim krejt misterioz; mbërritja te precizioni përmes presionit mbi gjuhën përkufizohet nga vetë Zogaj si momenti i një çlirimi të mundimshëm. Në poezinë e tij të hershme, *Afrohu Orë e Lumtur e Poetit*, e cila shfaqet në librin e tretë, *A Thua do të Vish Duke Qeshur*, duke medituuar mbi natyrën e poezisë së vet përmes përdorimit të teknikave poetike, Zogaj shpjegon:

*Ka disa kohë që shkrimi i poezisë  
më shkakton vuajtjen dhe dehjen  
e dhurimit të gjakut.*

Një qasje e tillë të sjell ndërmend pikëpamjen e Michael Weigers, sipas të cilit, "të shkruash mbi poezinë do të thotë, së pari, mundësi e gjetjes

së disa përgjigjeve edhe për pyetjet që poetët kanë rreth natyrës dhe origjinës së artit të tyre."<sup>4</sup>

## III

E parë si complete oeuvre, përmbledhja voluminoze, *Në Çdo Pasqyrë na*

Sheh Mëkati - e para përmbledhje e këtij formati nga poetët e brezit të Zogajt - për nga relievi i saj estetik dhe kuptimor është ndër përmbledhjet më të plota dhe më dinamike në dekadat e fundit. Botimi i një përmbledhjeje, në përmasa të tilla cilësore dhe sasiore, nuk është fort i zakonshëm ndër lëvruarit e poezisë lirike, ngaqë pak autorë ia dalin ta mbajnë përgjatë tërë karrierës, atë intensitet të veçantë formal dhe emocional që kërkon poezia. Edhe më i rrallë është ky fenomen në letërsinë shqipe ku, historikisht, shumica e poetëve i shkruajnë veprat më të mira fare të rinj dhe gjatë një periudhe të shkurtër shpërthyes, pa mundur ta mbërrijnë ekuilibrin e maturimit.

Profesor A. Pipa hyn ndër ata studiues që jo vetëm njohin përhapjen e këtij fenomeni në poezinë shqipe, por ai përpikëta ta shpjegojë atë me terma kulturorë dhe të psikanalizës. Në librin e tij *Letërsia Shqiptare, Perspektiva Sociale*, ai shkruan, "kordoni umbilical që e lidh autorin shqiptar me folklorin e mban atë në kryqëzimin e ID-

së me superegon, ndaj, kur ai përballet me krijues nga kombe civilizimesh të larta, (shpesh) e braktis misionin, tërhiqet, ngaqë i mungon vetësiguria që mëkohet vetëm nga një kulturë superiore"<sup>5</sup>. Profesor Pipa evidenton qartë dominimin e modelit pastoral të jetës në poezinë shqipe e cila, edhe në shekullin e njëzetë, me pak përjashtime, sillet brenda infrastrukturës së poemës epiko-lirike, duke shkruar masivisht pastish shpesh anakronike mbi platforma të njohura folklorike. "Letërsia Shqiptare ka një aromë të fortë rurale", vazhdon A. Pipa, "pasioni i realizmit socialist për folklorin motivohet nga një dëshirë e ndërgjegjshme për t'i mbajtur rrënjët në traditën kombëtare; e ka të vështirë t'i gjejë koordinatat estetike jashtë kontekstit shqiptar edhe për shkak të pasojave të krijuara prej shtypjes së gjatë politike dhe izolimit ekstrem". Fakti që edhe në dekadën e katërt të lirisë sonë politike, epitetet qesharake të llojit "patriark i poezisë shqipe" apo "bard modern" përdoren dendur si ndajshime komplimentuese në shtypin letrar dhe në media, e bën profesor Pipën të tingëllojë po aq aktual sa në vitin e largët 1978.

Për kontrast, te Preç Zogaj, për shkak edhe të formimit kulturor dhe letrar, në vend të kordonit të vetëm umbilical perceptohet qartë një vetëdije estetike e aftë për t'u informuar nga çdo praktikë e suksesshme poetike, pa e injoruar as poezinë më të mirë orale. Në këtë venë, përmbledhja *Në Çdo Pasqyrë na Sheh Mëkati* e formon tërësinë e saj me parimin e harmonisë së mozaikut, është shumësi teknikash poetike<sup>6</sup> dhe larmish tematike, të cilat konturojnë qartë një ndarje radikale me traditën fiksuar pas imitimit mekanik të platformave të gatshme.

Me ndarje radikale, kam parasysh refuzimin e adaptimit mekanik të folklorit, (kuptimisht si pikëpamje mbi botën dhe stilistikisht si rrugë e lehtë vjershërimi) dhe jo injorimin e plotë të disa prej teknikave të provuara të poezisë më të mirë orale për të mbërritur sublimimin poetik.

Preç Zogaj ka një marrëdhënie estetike të vetëdijshme, funksionale dhe komplekse me modelet më të mira të poezisë orale. Në një përpjekje të ndërgjegjshme për t'i bërë lirikën e tij më të çliuruar, ai jo rrallë përshtat tonin e lirikës popullore veriore, inskenon për shembull momentin e njohur arketip kur tjetërsimi fizik i së bukurës përjetohet keq tek i përvuajturi, por në një mënyrë krejtësisht të vetën. Konsideroni vendosjet e kujdeshme të vargjeve, "Kur ma ktheve shpinën, vera u bë dimër..." apo "Në t'u thinjtë floku, më keq do ta kem!" Edhe toni adhures, i shprehur shpesh me vargje si, "o e bukura ime, më e mirë se unë" - ton që i shkon aq shumë për shtat odesë - në mjaft raste vjen si kultivim i bazuar mbi konstruktet e lirikës orale, ku dorëzimi përpara bukurisë shprehet me një emfazë të matur.

## IV

Zogaj debutoi së pari si produkt i grupimit letrar lezhian, i cili nisi si një counterculture, por shpejt u bë epiqendër e një poezie ndryshe - më saktë, njëra nga epiqendrat e poezisë shqipe, e cila edhe për shkak të represionit politik në qendër, pati marrë karakter të qartë regional.

Poezia e Grupimit Letrar të Lezhës u shqua nga pasioni për ballafaqim me modelet më të emancipuara të poezisë europiane. Herë përmes dëgjimit ilegal të emisioneve për

poezinë në valët e Radio Italia, dhe herë përmes botimeve të huaja të gjetura me vështirësi dhe të përkthyer me elegancë të përkorë nga R. Marku, ky grupim kërkonte informim estetik përtej kontekstit shqiptar, i cili at'herë ishte, siç aludon Zogaj me një varg, "(një) stinë e thatë për poezinë". Për një lexues të informuar të poezisë, koordinatat estetike të Preç Zogajt luhaten herë midis Pessoa-s dhe Quasimodo-s, herë në hapësira ku dallohet prania e surrelizmit francez me fuzionin e njohur të realitetit me ëndrrën. Në jo pak raste, në procedimet e tij poetike ndihet edhe atmosfera e surrelizmit sui generis grek me enumeracionet e panumërta të efekteve të dritës. Në kërkimin e koordinatave të tij estetike, Preç Zogaj, ashtu si edhe Rudolf Marku - zëri tjetër i fuqishëm i poezisë shqipe të dalë nga epiqendra lezhiane e poezisë - e hap tremenë e tij origjinale përmes agon-it të vet të papërsëritshëm. (Agon, term i Harold Bloom në teorinë e tij për poezinë; është ai moment tensioni, kur poeti i vërtetë merr prej mjeshtrave paraardhës teknika poetike dhe komplikime kuptimore për të mbërritur një cak të ri estetik krejtësisht të vetin<sup>6</sup>.) Ky proces kompleks është sa i ndërgjegjshëm po aq intuitiv, prej tij përfitojnë jo vetëm poetët aktivë, por edhe vetë mjeshtrat që s'janë më, ngaqë mbahen në qarkullim rivitalizimi poetikat e tyre. Këtë proces ndërlidhesh estetikë indirekte, Anna Akhmatova e quante "korrespondenca përmes ajrit"<sup>7</sup>. Në poezinë shqipe, prej gjysmës së dytë të shekullit të 20-të e në vazhdim, ka edhe mjaft raste kur "tensioni" Agon nuk ka çuar në caqe origjinale, por në epigonizëm - shpeshherë në vend të "korrespondencës përmes ajrit" haset një transliterim mekanik modelesh të mjeshtrave të mëparshëm.

Shembujt janë të shumtë, por listimi i tyre nuk hyn në qëllimet e kësaj parathënieje.

Poezia e Preç Zogajt në katër dekada, organizohet si natyrat e qeta të Modigliani-it, vendos pranë e pranë vibrime idesh, peizazhe sociale, siluetime personale dhe hije metafizike. Për shkak të shqetësimit të tij të brendshëm mbi ndikimin e poezisë në jetën e të tjerëve, në vargjet e Zogajt zotëron empatia; nuk gjen aty, as midis rreshtave, kurrfarë cinizmi. Edhe kur fokusohet në padrejtësitë sociale dhe politike, ai e modelon heroin lirik si një alter ego dhe përmes tij, padit së pari vetveten pastaj komunitetin. Preferenca e Zogajt për të marrë mbi vete çka nuk i takon, të kujton thënien e famshme të Lasgush Poradecit, "Poeti është përgjegjës për gjithçka!" Kjo vetakuzë - formë e lartë empatie për absurdin e fatit kolektiv - ndihet qartë në poezinë Çasti i Rrezikshëm, shkruar dhe botuar në fundin e viteve '80,

*Oh, ç'fjalë të ëmbla për bukën thatë,  
Për rrenat pompoze, oh, ç'heshtje e gjatë.  
Ç'kujdes në të ecur dhe... nuk na shtyp makina,  
Ç'fuqi për të qeshur, shembullore për vitrina.  
Jo, jo, nuk them  
Pse dhëmbët më ranë,  
Pse gishtat m'u pakën  
E kërcet m'u thanë  
Se dua të rroj sot e pastaj  
Dhe rroj pa faj...*


*Mbushur stih, etje shpërthyes,  
Çast i rrezikshëm mbetet mbrapa,  
E shkuara dridhet  
Si fushë e minuar.*

Strofa përmbyllëse e poezisë së mësipërme përçon një frikë thujse fataliste përmes një pulsimi gati profetik, duke e ngritur poezinë në nivelin e një intrigimi provokues. Kjo pririje e lëvizjes drejt kompleksitetit kuptimor e bën Zogajin një profil krejt të dallueshëm krahasuar me mjaft poetë të cilët, edhe në fund të viteve '80, vazhdonin të shkruanin, në mënyrën më jo propocionale të mundshme, ato "poezitë e tagrit" që nxijnë edhe sot si vraga kulturore...

## V

Përmbledhja *Në Çdo Pasqyrë na Sheh Mëkati* dëshmon se poezitë e Zogajt, si lloje letrare, bëjnë gjestet estetike të odesë, ekloges moderne dhe elegjisë, ndërkohë që, varësisht nga përmbajtja, ato mund të lexohen edhe si poezi dashurie, lutje, protesta, momente meditimi, vaje dhe litani.

Siç dëshmon edhe kjo përmbledhje, Odeja, si lloj letrar, mbetet ndër format më të parapëlqyera të poezisë lirike, e pakohë dhe në evoluim të përhershëm. E rivitalizuar fillimisht prej romantikëve europianë, ky lloj i lashtë letrar që daton me antikitetin latin, u masivizua në shekullin e njëzetë, duke u bërë njësoj atraktive si për modernistët edhe për eksperimentuesit postmodernë. Në poezinë lirike për dashurinë, Odeja mbetet lloj letrar i pashmangshëm sepse, siç shprehet poeti bashkëkohor amerikan Robert Has<sup>8</sup>, "çdo poemë dashurie, pavarësisht nëse është përshkruese apo meditative, në thelb të vet përqipet të bëjë gjestin e odesë", ç'ka do të thotë: ka ton të theksuar adhurimi, diksion



elokuent, dhe përdorim të ndërgjegjshëm të efekteve poetike.

Tradita jonë letrare nuk ka pasur lirika dashurie të ndertuara mbi skena vizive, jo më pastaj skena surreale që vijnë si fuzion i ëndrrës me realitetin, ku ëndrra përshkruhet në detaje konkrete. Ka pasur orvatje - kujtoni vargjet e Kadaresë, "...pastaj si në rrugica parqesh/ shëtit mes cirkovolucionesh" - por jo realizime të njëmendta siç ndodh me odenë e Zogajt, *Balladë*.

*Po flija poshtë lisit hijerëndë  
Kur erdhën e më zgjuan, "ngrehu të do Ana,  
Muzikë më të bukur s'më kishin ndier veshët.*

*U hap mbi kodrat e verdha një deriçkë,  
Kraharori im kërciti si dërrasë  
Mes lulesh e gajtanash hapi sytë  
Ajo që nuk u bë më shumë se vajzë*

Kjo poezi-ode, vjen si ekzemplar i qasjes retorike Carpe Diem, përdor me finesë elemente dramatike për ta afruar lexuesin në atë çast skenik ku dëgjohet dialogu i heroit lirik me folësin e padukshëm.

*O ti që flet e s'dukesh, a vërtet,  
Më do ajo tani apo jam nëndërr?  
Përse më fshihesh o zë kaq i sinqertë*

Syri lirik i një mendjeje në punë e bën këtë poezi kampion të shkrimit imagjnativ; i ofron audiencës një moment të ngarkuar me skenografi detajesh, duke bërë një prerje prej traditës sonë të lodhshme të sublimit sentimental platonik, pa detaje konkrete, i cili, fatkeqësisht, vazhdon dhe shpesh, edhe ne rastet kur virtuozeiteti teknik nuk mungon, e dënon lirikën shqipe të dashurisë me anakronizëm.

Ndonëse sillen qartë rreth motivit të dashurisë, odet e Zogajt e rrisin përmasën e tyre kuptimore nëpërmjet

aluzioneve të shumta, veçanërisht të referencave indirekte nga Bibla. Metaforat e tipit, "Një mollë e përjetshme" apo vargjet aforistike të llojit "Në çdo pasqyrë na sheh mëkati," nuk ndalen thjesht në evokimin e mëkatit primordial, por shtillen në përsiatje të thella mbi natyrën njerëzore dhe pamundësinë tonë të brendshme për një katharsis përfundimtar. Amour, një ode e shkurtër, por me një thellësi të pazakontë, vetëm në katër vargje ia del të inskenojë krijimin e femrës, duke e kthyer heroin lirik në karakter biblik.

*Një brinjë më ikën e shkon të ngulet në rërë,  
Era fishkëllen në anën time të djathtë...  
Në duar mbaj  
Zgavrën dhe mallin.*

Teknika Carpe Diem - shijo çastin - dhe vizualizimi i çastit me imazhe konkrete e të qarta, e trondit lexuesin duke ngritur një luzmë pikëpyetjesh, përgjigjja e të cilave përbën të vetmen mënyrë për të zbuluar mënyrën se si ky shkurtim e bën kuptimin e vet. Në poezinë, Ne na njohu një e tretë, Dashuria, marrë nga vëllimi me titull homonim - botimi i fundit i autorit - në strofën e parë, Zogaj shkruan:

*Ajo qëndronte mes heshtjes sonë  
kur shiheshim gjatë si dy të pagojë  
dhe e dinim më parë çfarë ka në mendje tjetri,  
dhe flisnim dyshe edhe kur flisnim me vete...*

Strofa e sipërpërmendur të kujton konceptin e Ezra Pound-it, Logopoeia, "dancin e intelektit midis fjalëve", ngaqë përmes personifikimit e thekson fort idenë e dashurisë si një prani të domosdoshme te njeriu, si një forcë e natyrës e aftë për të kryer modelimin tonë shpirtëror. Kjo poezi manifeston edhe një marrëdhënie fine me traditën e poezisë lirike në shqip, ngaqë evokon thujse padukshëm filozofinë e Naim Frashërit për dashurinë si dimension







“Corriere della Sera” për  
botimin në Itali të romanit  
“Vera pa kthim”  
të Besnik Mustafajt

## Një muaj mjalti i ngrirë

Nga Marco Ostoni



Përkthimi në Itali në fillim të shtatorit nga shtëpia botuese “Bibliotheca” i romanit “Vera pa kthim” të Besnik Mustafajt po gjen një jehonë të gjerë në mediat italiane. Janë botuar afro 15 shkrime në portale të specializuara për kulturën në përgjithësi, posaçërisht për letërsinë, si dhe në gazeta. Radio me dëgjueshmëri të madhe, si Radio Vacanze dhe Radio Radicale, si dhe podcast-i “Il posto delle parole” kanë transmetuar intervista të plota me autorin. Midis tyre, për lexuesit e “ExLibris” zgjodhëm recensionin e gazetës më të rëndësishme, “Corriere della Sera”, në suplementin për letërsinë të datës 22 shtator 2024.

Një muaj mjalti i ngrirë  
Nga Marco Ostoni

Hyhet me kujdes dhe me pak mundim në romanin e mrekullueshëm të Besnik Mustafajt, “Vera pa kthim”, por shpejt magjepsesh, përpësh nga një shkrim imagjnativ, përfshirës dhe plot lirikë. Në fund, del i zbrazur dhe paksa i trullësuar, i drobitur nga përpjekja e ndjekjeve të rrëfimeve të panumërta dhe fantaziste të protagonistes Sana, e cila papritur ribashkohet me të dashurin e saj Gori, i rishfaqur befaz një mëngjes pas viteve të largimit misterioz. Të dy, pasi kishin ikur nga Tirana, do të kalojnë një muaj mjalti sflitës, por intensiv dhe të pazakontë, buzë detit në Durrës, me Gorin gozhdur në shtrat për pjesën më të madhe të kohës, i palëvizshëm, i rraskapitur dhe madje i paafte për të buzëqeshur për shkak të, siç thotë ai, një problemi me kockat.

Ndër shkrimtarët më të mëdhenj shqiptarë, Mustafaj – profesor, gazetar dhe politikan (ai ka qenë ambasador në Francë nga viti 1992 deri më 1997 dhe ministër i Jashtëm nga viti 2005 deri më 2007) – risjell dhe fiksionalizon këtu historinë e vërtetë të një dashurie të ndërprerë nga ngjarjet e mëdha historike në Shqipërinë e shekullit XX, duke përzier realitetin dhe ëndrrën, të tashmen dhe të kaluarën, shpresën dhe zhgënjimin. Romani mbërrin në Itali 35 vjet pas botimit të tij të parë në Shqipëri, pa prerjet e censurës komuniste tashmë, i përkthyer dhe i kuruar nga Julian Zhara. Nuk është një lexim i lehtë, por është një lexim që mbetet, me kusht që të shijohet ngadalë dhe me hurba të vogla.

## Festivali letrar ndërkombëtar për të rinj “Tirana Gate” 2024

Nga Irena Toçi

### NJERIU I SOTËM

Njeriu, kjo qenie e përkryer, e begatuar me një inteligjencë për ta pasur zili dhe një ndjeshmëri thujse të paimagjinueshme, që mbart në vetvete gjenetiksht historinë e qenies që prej fillimit dhe deri sot. I shqetësuar, i qetë dhe produktiv, i veshur me ambicie, i ndikuar nga zhvillimet e kohës, i vetmuar dhe pa vetëvlërësim, i shoqërueshëm dhe plot virtyte, i përgatitur për sfida të mëdha, i përgjegjshëm, i ashpër, i poshtër, vrasës, shpëtimtar, profesionist...

Kush është njeriu i sotëm?! A e njohim më shumë veten sot? A dimë të marrim prej saj më të mirën e mundshme për sa kohë na është dhënë të jetojmë? A jemi më të mençur për të gjetur atë që na plotëson, na lumturon, por na bën njëkohësisht të dobishëm për zhvillimet shoqërore? Çfarë ndikon te ne për të qenë më të mirë apo më pak të tillë? Përse kërkojmë me çdo kusht të jemi të parët? Sa nevojë kemi për tjetrin? Çfarë është dashuria që mendojmë se ndiejmë për të? Çfarë përfaqëson për secilin nga ne liria, qytetaria, zhvillimi? Sa të ngjashëm e sa të ndryshëm na bën kultura jonë e të jetuarit e trashëguar nga të parët tanë? Mos ndoshta sot, kur presidentë dhe kryetarë shtetesh, kryetarë partish apo korporatash janë edhe gra, bota ku jetojmë është më e mirë, më e balancuar, më e emancipuar?

Pse njeriut i pëlqen të nisë luftëra prej të cilave mund të mbjellë veç vdekje e shkatërrim?! Përse i duhet ky demonstrim force?! Cila është shtysa e brendshme që e bën njeriun e sotëm të jetë agresor?!

Përse dy njerëz që mund të kenë lindur dhe identifikuar si binjakë, e të jenë edukuar në të njëjtin mjedis familjar dhe shoqëror, mund të manifestojnë tipare krejt të ndryshme të karakterit, krejt të kundërta ndonjëherë?

Njeriu dhe vetvetja, njeriu dhe qyteti, njeriu dhe natyra, njeriu dhe shoqëria, njeriu dhe *inteligjenca artificiale* që vetë ai e krijoi, njeriu i sotëm përballë trynisë së kohës.

Këto dhe shumë pikëpyetje të tjera, që shkrimtarët të karrierës dhe shkrimtarët të rinj, i ngrejne në veprat e tyre letrare dhe na bëjnë për çdo ditë të mendojmë e të reflektojmë, do të bëhen pjesë e aktiviteteve të Festivalit Letrar Ndërkombëtar të të Rinjve “Tirana Gate” 2024, për tri ditë radhazi 9, 10 dhe 11 tetor në sallën “Tonin Harapi” të Liceut Artistik “Jordan Misja” në Tiranë.

Të gjithë me një mision për të shkëmbyer kultura, përvoja, histori, ndjenja dhe marrëdhënie njerëzore në një hapësirë letrare ku kryefjalë do të jemi vetë Ne, Njeriu sot, përballë Vetes - përballë Botës; të gjithë bashkë për të dëshmuar se tashmë Shqipëria nëpërmjet letërsisë e ka zërin e vet **europian**.

Mirënjohje për të gjithë shkrimtarët, përkthyesit e moderatorët pjesëmarrës. Mirënjohje për të gjithë krijuesit që ndriçojnë rrugët tona me veprat e tyre. Ata janë udhëheqësit tanë në botën e imagjinatës, duke na çuar përmes fjalëve në dimensione të reja dhe duke na ndihmuar të zbulojmë thelbin e dashurisë për veten, leximin, librin dhe vetë jetën tonë.

Mirënjohje Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës



dhe Inovacionit, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Bashkisë së Tiranës, Bashkimit Europian, Traduki-it, Institutit Gëte, Qendrës së Botimeve për Shqiptarët e Diasporës, Liceut artistik "Jordan Misja", Ambasadës Gjermane dhe Ambasadës Greke, Institutit Italian të Kulturës në Tiranë, Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, RTSH-së dhe "ExLibris" për mbështetjen e përvitshme të kësaj nisme.

"Tirana Gate" sot është e hapur për të mirëpritur artistët e penës së Europës sonë të dashur!

LISTA E AUTORËVE, PËRKTHYESVE DHE GAZETARËVE  
PJESËMARRËS

1. Alban Tufa - Shqipëri
2. Amanda Michalopoulou - Greqi
3. Ana Kove - Shqipëri
4. Antonio Caiazza - Itali
5. Arta Marku - Shqipëri
6. Ben Andoni - Shqipëri
7. Blerina Rogova Gaxha - Kosovë
8. Brajan Sukaj - Shqipëri
9. Clemens Meyer - Gjermani
10. Dejan Atanacković - Serbi
11. Diana Culi - Shqipëri
12. Eleana Zhako - Belgjikë
13. Erina Çoku - Shqipëri
14. Eris Rusi - Shqipëri
15. Florian Gantner - Austri
16. Ivana Trajanoska - Maqedoni e Veriut
17. Ledia Dushi - Shqipëri
18. Liridon Mulaj - Shqipëri
19. Loreta Schillock - Gjermani
20. Luella Myftari - Shqipëri
21. Majlinda Rama - Shqipëri
22. Maklena Nika - Shqipëri
23. Manjola Nasi - Shqipëri
24. Mimoza Hysa - Shqipëri
25. Namik Dokle - Shqipëri
26. Odise Kote - Shqipëri
27. Petar Denchev - Bullgari
28. Rigels Halili - Poloni
29. Rita Petro - Shqipëri
30. Stefan Çapaliku - Shqipëri



# Rudolf Marku - rapsodi i emigrimit bashkëkohor

Nga Vangjush Ziko

**K**am përpara ciklin dinjitoz poetik "Kujtim i largët" të poetit Rudolf Marku botuar në "ExLibris"

Tematika e këtij cikli është mjaft e gjerë dhe e pasur.

Unë po përqëndrohem në temën e emigrimit, një temë komplekse bashkëkohore mbi heroin apo heronjtë e tij të dënuar të bredhin nëpër botë për të siguruar mbijetesën e vet dhe të ëndrrave të tyre për jetën:

*"O miq të fëminisë që shumë e shumë vite më vonë,*

*Do ju shihnja një natë të ftohtë dimri, tek silleshit të hutuar*

*Burra të vvarë jete, emigrantë, rreth Arenës së Koloseut në Romë".*

Ata jetojnë në "vathën" e cila "ka formën e grataqieve prej betoni".

*Ata janë "të disiplinuar, blegërijmë në kor./ kurrë nuk kemi shprehur mosbindje tekanjoze" dhe "Dhe askush nuk e di se der' kur do jemi gjallë"/megjithëse: "E drejta e kafshëve mbrohet me ligj./Madje dhe ujqërit vetë do dënoheshin nga gjykatësit e rreptë të Hagës".*

Bëhet fjalë për një dramë kolektive që e përjeton edhe vetë poeti:

*"Dhe lotët e mia që i fsheha në një lakrimore,*

*të cilën e marrë me vete, fshehurazi, kudo që shkoj "*

Filozofia e jetës së këtij heroi është: "të mos kesh kujtesë/Shoqëruar me harrim", sepse vetëm kështu mund të përballohet antikapi shoqëror bashkëkohor i betejës së emigrimit:

*"pa asnjë plagë në trup*

*Asgjë heroike për t'u kujtuar, asnjë kronikë për t'u përmendur,*

*As dhe datën e rënies nuk ka se kush ta thotë,*

*Sepse në fakt nuk kishte asnjë rënie,"*

*.....*

*"betejë e mashtruar dinakrisht nga Historia."*

Dhe kori i emigrantëve vazhdon:

*"E megjithatë, në çastin e fundit, në qytetet tona,*

*Kthehemi thjesht po ashtu si trupat e ushtarëve të vvarë,*

*Anonimë, pa datën e lindjes a të vdekjes".*

Teksti i poezisë së Rudolf Markut është i ndërtuar sipas historisë së emigrimit bashkëkohor botëror.

Kordinator i vargut të tij është përemri vetor në njëjës dhe në shumës ("ne" dhe "ata"), i cili pasqyron botën shpirtërore individuale dhe atë kolektive.

Për Rudolf Markun poezia është forma e veçantë e komunikimit intim të poetit me lexuesin e vet nëpërmjet këtij bashkëbisedimi.

Ky bashkëbisedim prek tema të ndryshme, nga intime deri në ato më të mprehtat shoqërore.

Subjekti lirik i poetit bën të vetat nostalgjinë për të kaluarën dramatike bashkë me shqetësimin për aktualitetin botëror.

Poezia lirike e Rudolf Markut, poezi e shkruar me varg të lirë, është sa meditative, po aq dhe bashkëbiseduese me lexuesin.

Intonacioni i vargut të tij është i larmishëm plot variacione dhe gjendje të ndryshme emocionale e psikologjike të kësaj "mbijetese" dramatike dhe epike, njëkohësisht.

Vargu i tij i përshtatet denjësisht trajtimit të historisë, gjë që e bën atë jashtëzakonisht të veçantë.

Subjekti lirik përcjell shqetësimin e shoqërisë bashkëkohore në luftën e saj për ekzistencë.


Poetika e poetit është një gjuhë plot antiteza ambivalente, plot kontradikta të mprehta jetësore, të cilat i përcjell nëpërmjet alegorisë sarkastike të një "deleje të lumtur": "ushqimi është i dobishëm, askush nuk pyet për shijen"; "kasapët janë të sjellshëm dhe profesionistë"; "shtëpia është e rehatshme, çmimet rriten çdo ditë"; "e drejta e kafshëve mbrohet me ligj, madje dhe ujqërit vetë do të dënoheshin nga gjykatësit e egër të Hagës".

Semantika dykuptimshme e zërit poetik shndërrohet kështu në një zë të fuqishëm në "korin e kohës sonë".

Teksti poetik i tij kthehet në një fakt historik kuptimplotë.

Rudolf Marku me këtë cikël dëshmon jo vetëm vitalitetin e tij të pashterur krijues, por dhe ngjitjen e poezisë së tij në një lartësi realiste dhe artistike të re. Ai shndërrohet në një Rapsod lirik dhe epik i emigrimit bashkëkohor.





## Karikaturisti Arben Mexsi fiton çmimin e dytë në Festivalin Ndërkombëtar të Karikaturës Ferizaj 2024

Në qytetin e Ferizajt, Kosovë, u zhvillua konkursi ndërkombëtar i karikaturës me temë "Prodhimi dhe konsumimi i ushqimit: Sfidat e së ardhmes." Në këtë konkurs morën pjesë karikaturistë nga 59 vende të botës, ku u paraqitën 1,116 punime nga 253 autorë.

Qëllimi i këtij konkursi ishte të pasqyronte përmes metaforave të pikturave një temë kaq të ndjeshme në të shkuarën dhe në të ardhmen e njerëzimit. Juria ndërkombëtare, në fazën e parë të konkursit, seleksionoi karikaturat më të mira, të cilat shprehnin më qartë temën dhe kishin një nivel të lartë artistik. Nga këto u zgjodhën edhe karikaturat fituese. Karikaturisti Arben Mexsi fitoi çmimin e dytë, duke marrë medaljen e argjendtë me karikaturën "Sfidat e urisë." Karikatura fituese e Mexsit u vlerësua për metaforën e goditur, mesazhin që përcillte dhe nivelin e lartë artistik.

Ky është çmimi i dytë ndërkombëtar i Mexsit brenda këtij viti, pas atij të marrë në muajin maj në Kroaci. Ceremonia e dorëzimit të çmimeve u mbajt në qendrën kulturore të qytetit. Ky çmim ndërkombëtar i jep nder karikaturës shqiptare, e cila sot ka mbetur me shumë pak autorë.





rrathë imagjinare krejt miqësorë, që e zbavitnin pa masë.

Mati kishte qejf të vizitonte gjithçka: parkun, lëndinat, pemët e shumta, ku i dukej çdo gjë shumë e këndshme. Dhe kudo, kishte njerëz që bërtisnin me duar e me këmbë; sepse i bëhej sikur secili ishte në një ring të vërtetë! Por nganjëherë kjo panoramë e zhgënjente Matin.

- Gjithmonë, kështu bën ti, si i çmendur? - dëgjoi një zë të ashpër.

Mati pa para vetes dy policët që i kish vënë re në krye, sa doli në bulevard.

- Ka ndodhur gjë, zotërinj!...

Atëherë, polici i shëndetshëm e goditi me dorezën e pistoletës prapa kokës. Pasi ndenji paksa pezull, pa lëvizur, si ai shpendi grabitqar që vërsulet nga qielli mbi prenë e tij, ai ra përmbys, pa kuptuar gjë prej gjëje. Po të qe me ndjenja sa do të ishte revoltuar! Nuk po dëgjonte, por pranë tij fluturoi një dëshirë të madhe për ta hequr qafe si njeri, duhet për ta shkëputur sa më parë prej atyre murmurimeve të mallkuara. Mirëpo erdhi Cironka dhe ku nuk e godiste, duke u ndarë nga keqardhja dhe aq pa shkak, nëse Mati i mjerë as do ta kishte shtirë në mendje. Por ajo nuk kish parë asgjë. Një lloj ngurrimi e bezdie u duk sheshit në fytyrën e policit të shëndetshëm.

- Boll, - i tha. - Do të na mbetet në dorë!

Por ai, Cironka, në të kundërt, u ndje e kënaqur dhe u pushtua nga kureshtja, se pas pak mund ta priste diçka e bukur për të parë.

Në hijesirën e butë të gjetheve të gjelbra, ku bënte ballë një linjë e ngushtë drite e përhimë, si të mos e pengonte asgjë, e hipën mbi një stol druri, pranë tyre, vendosur përkundrejt pemëve; ndërkohë që, me sytë vigjilent, me një gjest picërrime të lehtë të syve, u larguan aq shpejt e shpejt, sa që edhe po të shfaqeshin kureshtarë, do të mbeteshin të habitur. E gjitha ishte befasi, një rrëmujë, që mund të dyfishohej, me ndonjë lajmëtar të padukshëm duke thirrur drejt daljes së bulevardit. Këmbë njeriu. Mati as lëshonte zë, as rënkonte, as lëvizte. Zallahahia ishte brenda dy policëve që e lanë shtrirë mbi dërrasa Murmurimën e mjerimit.

Së shpejti do të lindte dielli dhe për një kohë do ta linte gjithçka nën qiellin e shndritshëm të verës. Aty afër s'dihet sesi u gjend Lina. Një thirrje e dhimbshme mbushi hapësirën.

Tiranë, më 16 shtator 2024

#### Sinops:

Një djalë rreth të tridhjetave, sapo kish rënë në dashuri, ecte rrugës dhe bënte ç'bënte e numëronte njëmijënjë të ligat e qeverisë, duke folur si me vete. Fliste rëndë, por llafet nuk i kuptoheshin dhe aq mirë. E dashura e tij ishte thuthuqe. E kishte një cen. Po kur të përvishej të krijonte humor, sepse fjalët i dilnin ndryshe përndryshe. Përdorte shumë germen th... Aq u mërzhitën policët e patrullimit me të (djalin), sa iu vunë pas, e regjistronin dhe e donin ta mbyllnin në kafaz. Një ditë, para se të shkonte te shitorja e tij, vijonte sharjet me ku të ha e ku të djeg dhe arriti puna që ta rrihnin dy policë, njëri më i ngjallur se tjetri (njëri kish qenë polic droge, tjetri polic dogane dhe në llogot e tyre murrnin kush e kush anën e tij...), e bënë të vdekur tjetrin pse shante qeverinë me murmurime, derisa... vdiq në spital...

### In memoriam

## Terezina Zorba, historia e saj me cigare dhe me lotë

*Terezina Zorba, aktore, ish e përndjekur politike, basbkhëshortja e poetit Zef Zorba, u nda nga jeta me datë 6 tetor, 2002. E përkujtojmë sot, me intervistën e saj në librin "Women in Modern Albania" të Susan E. Pritchett Post si dhe me një përshkrim nga e bija e saj, Luçia Zorba kur kujton të ëmën.*

Terezina, 69, trupin e ka të ligsh dhe flet me duart, këmbët dhe zërin që i dridhen duke kujtuar dhimbjen. Përgjatë gjithë intervistës, pi cigare dhe loton qetësisht.

Kam lindur në Shkodër më 1927 dhe kam pasur një fëmijëri të këndshme. Nuk kishim probleme ekonomike dhe im atë punonte në konsulltën italiane të këtushme. Ferri për mua filloi kur ato erdhën në fuqi më 1944. Xhaxhai më hyri në burg pak pas Çlirimit për tentativë arratisjeje.

Në 1946, u përgjastova dhe shkolla dhe u burgosa. Në fillim më dhanë dy vjet arrest shtëpie. Po atë vit ndodhi Revolta e Postribës, revolta e parë dhe më e rëndësishme kundër regjimit komunist. Për pasojë, nuk e kreu asnjëherë arrestin në shtëpi, pasi u burgosa dhe e prita gjyqin plot katërmëdhjetë muaj në një qeli me burra, pa ujë për t'u larë çka ishte veçanërisht e vështirë kur më vinin menstruacionet. Një herë në ditë më lejohej të pija ujë dhe dy herë, të përdorja tualetin. Pjesa më e vështirë e asaj kohe ishte të dëgjoja të tjerët tek torturoheshin: Ulërimat e dhimbjes dhe zemërimet gjatë torturave. Për vete isha më keq sesa po të torturohesha. Kujtoj veçanërisht kur kushëriri im 21 vjeçar, djali i xhaxhait, pasi u përpoq të arratisë, u qëllua dhe u vra në shtator të 1947. Po ashtu, zëri i xhaxhait më jehon akoma në veshë teksa vdiq gjatë torturave. Në përfundim të katërmëdhjetë muajve, burri që më pas u bë im shoq si dhe unë u dënuam me nga pesë vjet burg.

Kur na përfundoi koha në qeli, filloi tortura e vërtetë morale. E vetmja gjë që mund të të nxirrte nga ajo jetë ishte spijunimi, çka ne e refuzuam. Bashkë me tim shoq, dolëm nga burgu, u martuam dhe bëmë fëmijë. Ai ishte piktor, shkrimtar dhe përkthyes, por asnjërit prej nesh nuk na u dha punë. Ajo çfarë më ofruan ishte të pastroja tualete. Një tortur e mëvonshme ishte të shihja fëmijët që, ndonëse ishin studentë të shkëlqyer, nuk ju dha e drejta për të ndjekur shkollën e lartë.

Personalisht nuk kam bërë asgjë, për qendrimi, për shumëkënd, do të thoshte shumë. Kam qenë dhe jam kundër shtypjes, qoftë e majtë apo e djathtë. Nëse dikush do të më kërkonte ta falja në emër të Jezu Krishtit, do ta falja, qoftë edhe ato, porse askush nuk e ka kërkuar ndonjëherë. Tani së voni [në 1991] Nexhmije Hoxha tha se ata kishin bërë ca gabime, sikur të kishin qenë vërtetë thjesht gabime.

Kur e pyesim ku e ka gjetur forcë, ajo përgjigjet thjesht: "Te besimi im në Zot."

**Luçia Zorba: Jam vajzë poeti, por pjesën më të madhe të poezive i kam mësuar nga nana ime**

Në nëntorin e vitit 1945, Tereza merr

bashkë me baben riprodhonin pjesë nga Juda Makabe duke i kënduar e rrecituar. Spektatore ishin ne, dy vajzat e tyre atëhere të vogla.

Tereza dinte shumë poezi përmendësh: Fishta, Prendushi, Manzoni, Carduci, Pascoli ishin poetët e saj të zemrës.

Jam vajzë poeti, por pjesën më të madhe të poezive i kam mësuar nga nana ime.

*Dhe në fund, ribotjmë poezinë e Zef Zorbës kushtuar së shoqes, "Tjera blerime", marrë prej Veprës së tij Poetike, botuar nga shtëpia botuese "Princ":*

Si lule dyelli gjethet,  
veshur me vapë e t'zberë  
e nuk lëvizin...  
e merrnin fymë me zor...  
e... oh...

S'andejmi  
ku paskeshin ngelur kujtesë brymore  
zgjohen flauri  
tjera blerime  
rinore.

(A të kujtohet? Atë verë  
burimet heshtja na i trazonte.  
këndoja vijat e fatit  
në dorën tënde flakë.  
Endeshim rrugësh të çuditshme,  
pa folë.

Pastaj n'teatër: një Gjido  
i larë në djesë  
përpëlitej i falisur.  
Ti shkuleshe ngaz me të madhe,  
por në sy të vetëtinte  
stuhia e Shtatorit...  
A të kujtohet?)



## NJË FIJE BARI MË THA

Një fiye bari që e vështrova ngultas  
Më tha se ajo kishte parë mbretëri dhe  
perandori  
Të shembeshin para syve të saj  
Sikur të ishin kështjella rëre

Ajo kishte parë oriflamë dhe flamurë  
Të zbukuruar me gjithfarë heraldikash e  
ngjyrash  
Të valviteshin mbi beteja  
Të kremtonin fitore  
Dhe lavdi jetëshkurtra

Ajo i kishte parë të zbërdheshin e të  
zhdukeshin  
Ndërsa ngjyra e saj kishte mbetur e  
pandryshueshme  
Sikur të kishte dashur të sfidonte  
Vjetrimin dhe ndryshmet  
Të dëshmonte se në këtë botë të gjerë  
Gjithçka nuk është e zhbëshme

Fija e barit më tha se atë e kishin shkelur  
Thundra dhe thembra të panumërta  
Por ajo ia kishte dalë mbanë  
Të ringrihej e të qëndronte në këmbë

Atë e kishin prerë me kosë  
Ajo ishte fishkur dhe ishte djegur deri në  
rrënjë  
Nga thatësirat dhe nga zjarret  
Që nuk kishin mundur ta shfarosnin  
As ta bënë të humbte shpresën  
Për t'u ringjallur dhe për të gjelbëruar sërish

Më në fund ajo më dha fjalën  
Se do të bënte rojë mbi varrin tim  
Se do të kujtohej për mua më gjatë  
Sesa të gjithë të njohurit e mi...

## ORA ME ZILE

Në agim  
Më buçet në veshë  
Tringëllima e një ore me zile

Nuk jam i sigurt  
Nëse kjo tringëllimë e zgjatur  
Vjen nga banesa e ndonjë fqinj  
Që do të niset në udhëtim  
Apo vjen nga gjetiu

Duke e dëgjuar ende gjysmë i përgjumur  
Jam i prirur të besoj  
Se kjo tringëllimë vjen nga ëndrra ime

Tashti që kam të drejtë të udhëtoj lirisht  
Por mosha më pengon  
Më vijnë ndër mend udhëtimet e ëndëruara  
Kur nuk kisha pasaportë për të udhëtuar  
jashtë vendit  
Dhe nuk kisha hipur kurrë në avion

Të strukura në nënvetëdijën time  
Udhëtimet e pakryera  
Hakmerren duke kurdisur pa dijeninë time  
Një orë me zile që më fton  
Të nisem për udhëtime të pamundshme

Nuk mund ta bëj të heshtë  
Tringëllimën ngulmuese të kësaj ore me zile  
Po aq sa ç'jam i pafuqishëm  
Të shtyj ardhjen e ditës  
Apo t'u imponoj vullnetin tim  
Ëndrrave të udhëtimeve të pakryera  
Të groposura në nënvetëdijën time...

## E MORA PËR DORE VJESHTËN

E mora për dore vjeshtën  
Duke i premtuar se do të shkruaja një poemë  
Për të dhe për gjethet e rëna

Sapo mbërrita me të në shtëpi  
Ajo zuri të qajej  
Duke thënë se i zihet fryma  
E ngujuar midis katër mureve

Unë i hapa të gjitha dritaret  
Me qëllim që ajo të mbushej me frymë

Meqë kjo gjë nuk mjaftonte  
I lashë hapur edhe dyert

Pa më marrë leje fare



# ANTON PAPPLEKA

## Një fiye bari më tha

poezi

Vjeshta i shtyu me bërryle muret  
Nga njëri horizont në tjetrin

Atëherë ajo zuri të vallëzonte me erërat  
Duke tundur në ajër gjethet e rëna  
Shami dasmorësh të dehur nga hareja

Kur u lodh së vallëzuari  
Vjeshta fshiu ballin me shaminë e mëndafshtë  
të një mjegulle  
Pastaj filloi të mblidhte gjethet e rëna  
Duke thënë se me to do të bënte një  
përmbledhje  
Ku do të përfshiheshin poemat që kishin  
shkruar për të  
Poetët e të gjitha kohërave...

## ËNDRË

E pashë veten duke rendur  
Me kokën time të prerë nën squetull  
Nëpër një rrafshinë të përgjakur

Më ndiqte pas një trumbë kalorësish  
Me helmata të ndryshkura

Ata donin ta rrëmbenin  
Kokën time të prerë  
Për ta ngulur në një hu  
Dhe për të hedhur rreth saj një valle tribale  
Të shoqëruar me britma triumfi  
Dhe me ulërima

Unë rendja nëpër rrafshinën e përgjakur  
Me kokën time të prerë nën squetull

Kalorësit që donin ta rrëmbenin  
Kokën time të prerë  
E mbushnin nënqiellin me trokëllima  
Dhe me xixëllima potkonjsh

Vallë edhe sa kohë do të qëndroja në këmbë ?

Kush do të shembej përdhë i pari  
Unë që e ngjethja rrafshinën me gulçimet e mia  
Apo kalorësit dhe kuajt e tyre të harbuar  
Që nxirrnin nga goja shkumë të përgjakur ?

Këtë gjë nuk e dinte  
As rrafshina e pafundme ku rendja  
Me kokën time të prerë nën squetull  
As dielli që na vështronte nga lart  
Me mospërfillen e tij kozmike...

## KËRKIM

Eca 99 vjet  
Pas ëndrës sime

Kapërceva 99 ura  
99 qafa malesh

Udhëtova drejt saj  
Nga 99 porte dhe aeroporte

E kërkova në 99 adresa  
Telonova në 99 numra telefonash

Hipa e zbrita 99 shkallë  
Trokita në 99 dyer

Pyeta 99 falltare se ku mund ta gjeja  
Nga ato mora 99 përgjigje të rreme

Për të më dhënë zemër  
Ëndrra ime më pëshpëriti në gjumë :

*Edhe po të kishe 99 jetë  
Ti duhej të vazhdoje të ecje pas meje*

*Atë ditë që ti do të më takojë  
Unë do të pushoja së qeni ëndërr...*

## UJQIT VETMITARË

Më kanë thënë se ujquit  
Kalajnë nëpër fshatin ku kam lindur  
Shuajnë etjen në breg të lumit

Ata ngrenë kokën konike drejt qiellit  
Dhe zënë të ulërijnë  
Duke shpresuar t'i mallëngjejnë hënën dhe  
yjet

Karvanet e reve  
Që përkrahjnë kupën e qiellit  
Si varganët e fshatarëve  
Që i braktisën ato vise

Të rrethuar nga heshtja e llahtarshme  
Ujqit vetmitarë kanë nostalgji për kopetë e  
dhenve  
Për blegërimat dhe këmborët e tyre  
Që jehojnë veç në kujtimet e mia

Ata ulin kokën drejt tokës  
Të turpëruar ngaqë janë të pazotë  
Ta ringjallin kohën e ikur

Në këto çaste  
Edhe unë kam ndjesinë sikur jam  
Një ujq vetmitar  
Që ngre kokën konike drejt qiellit  
Dhe lëshon një ulërimë të kobshme

I pushtuar nga malli për peizazhet e fëmijërisë  
Kam frikë se mos shndërrohem në një njeri-  
ujq  
Se mos ngarend drejt fshatit tim  
Për t'i falur një cirkë jete...

## PAMUNDËSI

Në mes të kremtimit të Natës së Vitit të Ri  
Në bashkinë e Parisit  
Një vajzë që ndodhej pranë meje  
Më ftoi të vallëzoja

Për të mos u treguar i pasjellshëm  
Unë i thashë se më pengonin të vallëzoja  
Flokët e bardhë që kisha në kokë

*Atëherë qethi zero ! m'u përgjigje ajo  
Dhe ia shkrepiti të qeshurit*

Unë e dija se berberi i parë  
Që gjendej te cepi i rrugës  
Mund të m'i hiqte qafe flokët e bardhë

Por as në tokë as në qiell  
Nuk ekzistonte një dorë magjike  
Që mund ta bënte *tabula rasa*  
Pyllin e kujtimeve të trazuara  
Të fshehura brenda kafkës sime

Po t'ia kisha shprehur këtë mendim  
Vajzës që ndodhej pranë meje  
Ajo do t'ia kishte shkrepur prapë të qeshurit...

Paris, 1 janar 2024

NJË PËLLUMB NË KOPSHTIN E  
POETËVE

I ulur në një stol të kopshtit të poetëve  
Shoh në lëndinë një pëllumb  
Që ecën plot besim drejt meje

Për të mos e lënë të zhgënjehet  
Unë i drejtohem me zë të ulët :  
Në qofsh i uritur pëllumb  
Mos eja tek unë

Nuk kam ç'të të jap  
Përveç zemrës sime të sëmurë  
Nga e cila nuk mund të zhvatësh  
As kafshatën më të vogël

Nuk kam ç'të të jap  
Përveç thërrimeve të ëndrrave të mia  
Që i shpërfillin edhe thneglat

Pëllumb i uritur  
Afrohu më mirë te poetët e vdekur  
Që ndoshta mund të ta shuajnë urinë  
Me vargjet e tyre të ngallmuara në gurë  
Të rrethuar nga bari dhe lulet

Tashti unë dyshoj  
Se vargjet dhe gurët ku janë ngallmuar  
Janë të përjetshëm

Pëllumb  
Thuajmë a ka diçka të përjetshme  
Me përjashtim të faktit  
Se asgjë nuk është e përjetshme ?

Pëllumbi fluturon drejt caktit të vet  
Moskokëçarës ndaj pyetjes sime  
Për vdekjen dhe përjetësinë...

NJË YLBER I NGALLMUAR NË  
KRAHARORIN TIM

Qysh nga data 15 korrik 2024  
Një pjesë e zemrës që rreh në kraharorin tim  
Është fizikisht franceze

Qysh atëherë  
Ritmi im kardiak është përforcuar  
Nga jehona e ritmit të Marsejezës  
Sikur zemra ime të kishte gjëllitur  
Një gllënjë nga Burimi i Rinisë së Përherëshme

Edhe gjaku im i kuq  
Që vazhdon vallen e pandërprerë  
Në qarkun e artereve dhe të venave të mia  
Përreth rrjedhës së tij shpërndan  
Ylberëzime tringjyrshe

Në ditë që më kanë mbetur ende  
Fati ka vendosur të rroj  
Me një ylber të kaltër të bardhë të kuq  
Të ngallmuar në kraharorin tim..



## SHI VERE

Në korridorët e gjata të spitalit të qiellit  
Kalojnë infermieret e reve të bardha

Të alarmuara nga sinjalet e vetëtimave  
Nga sirenat e bubullimave shurdhuese  
Ato mbajnë në duar  
Shringat e holla të shiut  
Të cilat ia ngulin tokës  
Që vuan nga dehidratimi  
Për shkak të thatësirës

Serumi jetëdhënës i shiut  
Qarkullon në damarët e tokës  
Duke e kërthnezur gjelbërimin

Dielli që nxjerr kokën  
Nga gallustra e një kthjelline  
I ngjan një radiologu me kapuç mbrojtës  
Që në mushkëritë e tokës ka zbuluar  
Tumoret e zonave të thara apo të shkretëtirta

Nëpër kuadraturën e dritares  
Të dhomës ku jam shtruar në spital  
Unë kundroj infermieret e bardha të reve  
Që kalojnë nëpër korridorët e gjata  
Të spitalit të qiellit  
Nga ku vazhdon të bjerë  
Ky shi vere...

*Spitali Saint Antoine, 16.7.2024*

## ORA E NËNËS SIME TË VDEKUR

Në mugesë të një ore dore  
Nëna ime që rronte në fshat  
I maste orët e ditës me lëvizjen e diellit  
Dhe me hijen që lëshonin shkëmbinjtë

Me rastin e një ditëlindjeje të saj  
Unë i dhurova një orë dore  
Të pajisur me numra të mëdhenj  
Me të cilat ajo mund të maste orët  
E viteve të mbrame të jetës

Pasi mbylli sytë  
Ku mbeti e ngujuar drita e diellit  
Nëna ime mori në banesën e fundit  
Edhe orën që i pata dhuruar  
Pëng i dashurisë birnore

Atje larg ku ajo prehet  
Në mugëtirën e varrit të saj  
Unë e marr me mend se ora e dorës  
Që i kam dhuruar dikur  
Asaj i duket si një diell i vogël

Me akrepat dhe numrat e saj  
Nëna ime e vdekur përpiqet të matë  
Orët që na ndajnë  
Nga takimi ynë i pashmangshëm  
Të cilin ajo e ëndërron dhe njëherësh uron  
Të shtyhet sa më shumë që të jetë e mundur...

## GURI I NJË VARRI ANONIM

Pushoni së foluri për mua  
Tashti nuk kam më veshë  
Për t'ju dëgjuar

Unë jam një gur varri  
Një njeri i shndërruar në një gur  
I pazoti për të shprehur një ndjenjë një mendim

Unë jam aty ku nuk ka më  
As ndjenja as mendime

Tashti unë jam një gur  
I vënë te kryet e varrit të një njeriu pa emër  
Nga i cili nuk ka mbetur gjë tjetër  
Veç këtij varri shurdhmemec e të verbër  
Mbi të cilin pikojnë vetëm lotët e shirave  
Dhe vetëm bulat e gishtave të erërave  
E prekin me gjeste njerëzish që kanë lindur  
të verbër

Unë jam një gur varri  
Pika e vënë në fund të një fraze  
Të quajtur një jetë njerëzore

## NJË VËSHTRIM

Vështrimi i saj  
Mesazhet e panumërta e të pazbërthyeshme  
Të përcjella prej tij

Ai shpreh diçka që nuk gjendet  
Në të gjitha tekstet e shkruara qysh nga  
shpikja  
E shkrimit hieroglifik kuneiform alfabetik  
Ai shpreh atë që nuk thuhet dhe atë që është  
e parrëfyeshme  
Ai shpreh një mister që mbetet i  
pashpjegueshëm  
Edhe për sytë që e përcjellin  
Siç mbetet e pashpjegueshme drita për yllin  
nga i cili buron

Ai vështim mbetet i tillë edhe për sytë që e  
kapin  
Që përkulen mbi të si mbi qermin e një pusi  
me dritë yjore  
Ku kanë dëshirë të pinë pafundësisht  
Duke pasur përshtypjen se po shuajnë etjen  
Me glënjka përjetësie

Një vështrim që buron nga sy  
Të cilët ruajnë midis qerpikëve  
Dritën e Big Bangut...

## ARKEOLOGJI

Qysh para katër mijë vjetësh  
Në kohën e faraonit Pepi II  
Kanë ekzistuar plaçkitësit e varreve

Ata kanë thyer pllakat e gurta të sarkofagëve  
Ua kanë prishur gjumin të vdekurve  
Kanë plaçkitur blatime dhe sende të çmuara  
Që mund të shiteshin  
Kanë shpërndarë andej-këndej eshtrat e  
mumjeve  
Pa pasur frikë nga zotat as nga formulat  
magjike  
Pa përdëllim për të vdekurit

Koha që ka rrjedhur  
Ka marrë me vete në lumin e saj të  
paktëshëm  
Faraonët dhe perandoritë e tyre  
Skribët dhe ligjet e shalitura  
Në gur në deltinë dhe në papirusë  
Ka marrë me vete zotat  
Që besoj se ishin të përjetshëm

Vetëm raca e plaçkitësve të varreve  
U ka mbijetuar ndryshimeve dhe mynxyrave  
Të shkaktuara nga natyra dhe nga njerëzit

Plaçkitësit e varreve janë përherë aty  
Për të përsëritur gjestet e stërgjyshërve...

## MEDALJA

Gjatë lojërave olimpikë  
Trupat e gjimnasteve fluturonin në ajër

Ato dukeshin sikur ishin  
Krijesa jashtëtokësore  
Që kishin ardhur në Paris për të na lëbyrir  
Me trupat e tyre të shndërruar  
Në elipse guximi  
Përsosurie  
Bukurie

Fytyrat e tyre ndritën  
Si medaljet që fituan  
Diej të vegjël ngadhënjimi  
Mbi kraharorët e tyre

Këto imazhe u vdarën  
Për t'i lënë vend një gjimnasteje  
Që gjatë ekzekutimit të ushtrimeve  
E humbi ekilibrin  
Dhe ra në dysheme

Me fytyrë të ngërthyer  
Ajo pati kurajën të ngrihej  
Ta çonte ekzekutimin e saj deri në fund  
Në mënyrë të përkryer

Fytyra e kësaj gjimnasteje  
Në çastin që u ngrit pasi kishte rënë  
Mbeti e gdhendur  
Në kujtesën time...

*Paris, 2.8.2024*

# Vëzhgim mbi librin "Portrete pa kornizë" të tregimtares Ajkuna Dakli

*Nga Flurans Ilia*

Ajo që është për t'u përhëndetur, është forma e përjetimit të librit "Portrete pa kornizë" (Onufri, 2023) me autore Ajkuna Dakli. Si ritëm, e rëndësishme kjo në mbarëvajtjen e leximit. E kam fjalën ngushtësisht për lexuesin këtu. Sepse dihet, një libër mund të shkruhet për arsye dhe nga rrethana të ndryshme, por tek e fundit, ai është i farëzuar për lexuesin qysh në zanafillë. "Portrete pa kornizë" më foli në atë mënyrën e vet të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, pa shumë stërholime letrare, në të njëjtën kohë kur pas kësaj thjeshtësie vëreja një ndërtim të brumosur nga një letërsi e mirë realiste. Është vështirë për krijuesin e sotëm ta mbajnë rrëfën në këto përmasa pa i humbur drejtpeshimet, çka në fakt është një teh teje i hollë dhe i mprehtë për të mos e lëshuar fillin e tekstit. Shumë prej nesh e thejnë padashur këtë. Ajkuna ja ka dalë mbanë ta mbaj të pastër tekstin, në një linjë të atillë të njëtrajtshme që tërheq dhe zbraps me ndjesi njerëzore.

Për njerëz të brezit tonë dhe njëherazi emigrant, forca e përjetimit padëshim është e dyfishtë. Dua të them se ky libër i flet kësaj kategorie lexuesi.

Te kapitulli "Rrugë të gjata" sa më e fortë bëhej forca e fërkimit po aq shpejtë përparonte leximi te tregimet : Karroca, Ditë celulash, Një ditë e shkëlqyer për të ecur, Epikë netësh pa drita, Mure të verdhë, Gruaja e vjetër në verandën me lule, Rrugë e gjatë (sidomos ky i fundit). Sepse aty gjeta një dramë të përbashkët si rrëfim i pastër. Unë e quajta nën zë këtë kapitull si "kapitulli i mbyllur i brezit tonë" që duhet rrëfyer. Në faqen 66, ndërsa përshkoja me sy fjalinë e fundit të kapitullit, "Po tani ajo dorë iu duk si një germë e lënë përgjymë." Papritur, syri më tradhtoi! Dhe nuk e kam fjalën te ndjesia si lexues, apo stili dhe forma e tekstit, por te shkëndija njerëzore e ringjallur brenda njeriut. Kjo është, i thashë vetes, forca që duhet të përçojë teksti. Të tregosh historinë tënde dhe ndjesinë brenda saj ta bësh burim ndjeshmërie të tjetrit.

Kapitulli "Portrete" kishte marrë ritmin e vet tashmë dhe përshkohej pa vështirësi leximi. Nga tematika e tregimeve ka kaq shumë për të thënë te lexuesi kanadez apo ai amerikan, aq sa gjithkush e gjen veten aty po aq sa lexuesi shqiptar. Sidomos njeriu (personazh tashmë) i të dy brigjeve. Nën zë e quajta si "kapitulli i rehabilitimit" apo njëfarë rimëkëmbjeje jo konvencionale të grackës tonë si emigrant. "Mbi vetminë dhe çështje të tjera" dëshmon integritetin e librit të Ajkunës. Që do të thotë : autorja nuk e lë të bjerë ritmin por e mban në këmbë drejt hapit final.



Tani dua të ndalem në ca sekrete të vogla të ashtuquajtura "teknike" të stilit të Ajkunës si tregimtare. Dialogët e "Portrete pa kornizë" janë organik dhe të natyrshëm, biseda të gjalla, në një trill të bukur letrar. Mbyllja, akti final i rrëfimit, është një gurë i çmuar që Ajkuna mbart si dhuratë falë talentit të saj. Për mua kjo dëshmon dy gjëra kryesore: 1. Që Ajkuna është një lexuese e ushqyer me letërsi të mirë. 2. Që autorja ndodhet përherë me përpikmëri në zotërim të tekstit të saj gjer në fjalinë (fjalën) e fundit, çka është pika ku kulmon një tregim i mirë. Stili i Ajkunës është kaq i thjeshtë sa sfidon çdo lloj forme dytësore. Ajkuna Dakli është një shkrimtare realiste.

Ndoshta u zgjata pak, por e shoh si autore që është gati tashmë për romanin e saj të parë apo në kalimin nga tregimi i shkurtër te novelat. E them me sinqeritet këtë. E meqë jemi te sinqeriteti, më kujtohet se kur lexova "Çizme lëkure në kohë lufte" (libri i saj i parë me tregime, botuar po nga Onufri, 2020) i kisha shkruar diçka të përafërt, "Mund të bësh akoma edhe më mirë."

Me librin "Portrete pa kornizë" autorja Ajkuna Dakli e ka kapërcyer "hapësirën kalimtare" të identitetit si krijues dhe i uroj një udhë të mbarë në aventurën e bukur të radhës.







**TRI ROMANE NGA MIEKO KAWAKAMI**

E lindur në Osaka në 1976, Mieko Kawakami botoi novelën e saj të parë Egoja ime, dhëmbët e mi dhe bota, në Japoni në vitin 2007, dhe u vlerësua me Çmimin Tsubouchi Shoyo për Shkrimtarët e Rinj. Vitin pasardhës, botoi si roman versionin e zgjeruar të kësaj novele, nën titullin *Gjinj dhe vezë*. Fitoi Çmimin Akutagawa, vlerësimi më i lartë në letërsinë japoneze. Është autore edhe e dy romaneve të tjerë, *Qiell* dhe *Gjithë dashnorët e natës*, botuar nga Onufri. Të njohur për cilësitë e tyre poetike, depërtim në trupin e gruas, dhe preokupimin me etikën dhe shoqërinë moderne, librat e saj janë përkthyer në mbi njëzet gjuhë në të gjithë botën. Jeton në Tokio.

# Identiteti dhe vitaliteti i Bienales Ndërkombëtare të Artit Bashkëkohor të Durrësit

*Nga Massimo Scaringella, Kurator*

Sado e gjerë të jetë një ngjarje kulturore, ajo kurrë nuk mund të pasqyrojë në mënyrë shteruese kërkimin krijues në zhvillim të vazhdueshëm. Por sigurisht ngjarje të tilla si Binalja Ndërkombëtare e Artit Bashkëkohor të Durrësit, e cila ekspozon 40 artistë nga 17 vende të ndryshme të botës, ku përpos pavijonit kombëtar të Shqipërisë, pjesë e saj janë edhe pavijonet kombëtare si: Amerika, Finlanda, Italia, Turqia, Kina, Kosova, Gjermania, Maqedonia e Veriut, Peruja, Zvicra, Tjavjani, Republika Dominikane, Suedia, Bregu i Fildishtë, Rumania dhe Argjentina të cilët falë kësaj larmie antropologjie kulturore ndërkombëtare mund të japin një ide për rrugën aktuale të artit bashkëkohor dhe gjallërinë e tij.

Në fakt, njohja dhe ndërveprimi me veprat e artistëve të një rëndësie të madhe, të cilët eksperimentojnë me shtigje të reja krijuese dhe mjete të reja për të kuptuar gjenialitetin e tyre, na ndihmon të njohim jo vetëm një çështje estetike, por sigurisht edhe një vlerë shoqërore dhe politike të lidhur me identitetin e veçantë të vendeve të origjinës.

Me përzgjedhjen e tyre është dashur të nxjerrim në pah disa shtigje që zbulojnë jo vetëm tendenca të caktuara piktorike dhe mjedisore, por edhe disa kërkime të thelluara nga pikëpamja konceptuale dhe teknologjike. Nuk është rastësi që themeluesi dhe kuratori i këtij edicioni të parë të Bienales Ndërkombëtare të Artit Bashkëkohor të Durrësit Ph.D. Oltsen Gripshi ka kërkuar të hulumtoj, apo të ftoj artistët të interpretojnë temën: **“Inteligjenca artificiale: e ardhmja hibride”**, një qasje konceptuale e kuratorit Gripshi, që eksploron integrimin në rritje të inteligjencës artificiale (AI) në shoqëri, duke theksuar se si kjo teknologji po tjetëron mënyrën se si jetojmë dhe punojmë. Ku koncepti i “të ardhmes hibride” i referohet një të ardhmeje ku inteligjenca artificiale dhe inteligjenca njerëzore bashkëpunojnë dhe plotësojnë njëra-tjetrën, duke krijuar mundësi të reja dhe duke adresuar sfida të ndërlikuara të gjithanëshme. Sepse vetëm me eksplorimin brenda temave të ndryshme me të cilat shprehet arti bashkëkohor është e mundur



të kuptohen realitetet e ndryshme krijuese në veprim, si pjesë e të jetuarit aktual brenda një vendi, edhe kur ai shfaqet përmes disa artistëve të cilët në raste dhe për motive të ndryshme, veprojnë jashtë kontekstit të tyre lokal, duke përbashkuar kështu kulturat e larmishme që kanë prekur e përjetuar përgjatë rrugëtimit të tyre si krijues.

Artistët që karakterizojnë këtë rrugë krijuese shikojnë të gjithë brenda origjinës dhe qenies së tyre, duke zgjedhur gjestin dhe formën ideale, mes përmasave për të kundërshtuar, ngjyrave për të ekspozuar, fjalëve për të sugjeruar dhe shenjave ëndërrimtare për të sublimuar. Një vizion dhe një koncept në të njëjtën kohë autentik dhe i natyrshëm, një kuptim i pastër në të cilin theksohet qendra e krijueshmërisë së formës. Në këtë mënyrë ata arrijnë edhe një herë misionin e artistit: atë të një fushëpamjeje gjithnjë e më të ashpër të realitetit në të cilin jetojnë. Legjitimiteti i tij jepet duke qenë gjithmonë një frymë e lirë në të cilën baza e mbijetesës estetike është kërkimi dhe jo rezultati praktik.

Për këtë arsye, artisti që e koncepton, rrezikon dhe supozon këtë realitet (ndonjëherë fizik) nuk i intereson kalimi i kohës. Prandaj, veprat e pranishme në këtë Bienale shënojnë një rrugë të mundshme në realitetin artistik bashkëkohor, duke u shfaqur së bashku me artistët të mirënjohur në nivel ndërkombëtar dhe disa artistë të rinj premtues që ngjallin shpresë për të ardhmen e tyre dhe të aftë për të prodhuar vepra të jashtëzakonshme për nga qasja konceptuale-filozofike dhe semiotike për nga përmbajtja e tyre.

Por dihet gjithashtu se ngjarjet artistike të këtij niveli kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për komunitetet që i presin ato, duke sjellë përfitime të shumta kulturore, sociale dhe ekonomike. Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet sociale, historike dhe mjedisore, të trajtuara shpesh përmes veprave të artit. Për qytetin e Durrësit, por besoj për të gjithë Shqipërinë, shpresoj që kjo bienale të sjellë atë kontribut në njohjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore dhe artistike të një rajoni që ka histori shekullorë duke stimuluar ardhjen e vizitorëve dhe turistëve.

Në përmbledhje për sa më sipër, një ngjarje artistike nuk është vetëm një festë e krijimtarisë dhe shprehjes njerëzore, por edhe një katalizator për zhvillimin kulturor, social dhe ekonomik të një komuniteti.



Romani **Mossanga**  
i Fate Velaj

## NJË ROMAN PËR KUJTESËN KOLEKTIVE

Nga *Monika Stafa*



Në dekadat e fundit është provuar se shumica e diskutimeve dhe debateve mbi të kaluarën komuniste në vendet e Evropës Lindore është përqëndruar kryesisht në problemin e ruajtjes së kujtesës kolektive dhe se si faqet e saj duhet t'i shërbejnë historisë së një kombi. Kujtesa kolektive është një faktor thelbësor në formësimin e "politikës historike" të cdo kombi dhe shteti, i cili është i vetëdijshëm për të kaluarën e tij.

I pakontestueshëm është fakti se programet e edukimit historik të shoqërive edhe në letërsi por marrin gjithmonë e më shumë përmasa njohjeje, cka do të thotë se rrethrotullimi i kohës brenda individit po bën trajektoren e nevojshme të saj. Proceset e përpunimit të kujtesës kolektive luajnë një rol të domosdoshëm në formësimin e së ardhmes, në ndërgjegjësimin e brezave.

Nën shijen e një kohe për të cilën lind nevoja të shkruhet na vjen papritur në dorë një roman aspak i zakonshëm.

'Mossanga' i Fate Velaj.

Romani është një zë i kohës, një vepër artistike ku mes një morie ngjarjesh plot ritëm që shtrihen në një strukturë të mirëndërtuar lexuesi mëson se çfarë ishte e natyrshme në Shqipërinë socialiste. Jeta në një qytet jo fort të vogël si Vlora për t'u shtrirë më pas në Tiranë, kryeqytetin e një vendi totalisht të izoluar edhe nga vetë kampi socialist ku ai me dëshirë kish vendosur të marrë pjesë. Një Vlorë që vazhdon të mirëpresë të huaj prej shekujsh duke shkrirë fatin e vet në lëkurën e tyre.

Mos vallë është kjo arsyeja përse udhëheqësit vazhdojnë ende ta lakmojnë si qytet, dje, sot dhe nesër?

Mister do të mbetet edhe për shkrimtarët modernë si F. Velaj.

Ky qytet me një breg të thellë 'pasionesh' si e folura e banorëve të tij me sa duket josh.

Dhe letërsia e tij merr papritur karakter dëshmuës. Një letërsi me fare pak vëmendje nga autorët shqiptarë.

Në të gjitha kohërat letërsia dëshmuës ka qenë pjesë e historisë së shkrimeve ndaj dhe "Mossanga-ën" nuk mund ta heqësh nga dora pa shënime jashtë tekstit. Autori për secilën ndodhi të hedhur në përmbajtje nuk harron për asnjë cast të japë dëshmi referenciale për epokën, shprehur në fjalë

metaforike e përshkrime fantastike mbi natyrën duke na çlodhur nga kanati në kanat prej ankthit të kohës.

Pikërisht i vendosur në funksionet e një dëshmitari, kronikani apo dhe historiani, letërsia e F. Velaj përgjithësisht dhe "Mossanga" cilësisht, bazohet mbi traditën e mirë të një letërsie tjetër, që sot në auolat mësimore dhe jo vetëm europiane po shërben edhe si një dëshmi e një kohe jo fort të largët. Epokës komuniste për të cilën sot ende shkruhet pak.

Ngjarjet në roman njohin një kohështrirje mesatarisht jo fort të zakonshme për një roman. Aty përshkruhet Shqipëria komuniste e vitit 1966 me liberalizimin e saj, vitet e errëta nën dimrin e madh e deri mbërritja e vitit Zero.

Sërish fillimi. Sërish tronditja. Viti 1991, kur personazhet e librit ndjekin fatin e tyre të brishtë teksa largohen nga Shqipëria.

Në të gjitha kohërat letërsia e historia kanë pasur një kushtëzim të ndërsjellë. Gjatë tre dekadave të fundme ky kushtëzim është shfaqur në dy forma kryesore: si qëndrim i letërsisë ndaj historisë e si plotësim, interpretim e shpjegim i saj. E ndoshta kjo është koha kur letërsia dëshmuës po njih një vërshim të vërtetë duke u bërë pjesë e qëndrueshme e rrjedhave letrare.

'Mossanga' është prova më e bukur e plotë në kuptimin e saj. Mbushur me histori nga bota e lindjes komuniste, me personazhe të skalitur mirë, aty tek dhoma e djemve nga Kongo mund të gjeje gjithcka shkruan autori: dhimbje, dashuri, mall, humor, gëzim ku me absurdin e një të ardhmeje të panjohur mund të kish dëshirën të këndoje por dhe të kërcëje.

Të qaje gjithashtu.

Megjithëse frika e kohës ishte një peshë e paevitueshme.

Shqipëria ishte një vend i izoluar plotësisht në varfërinë e vet. Një izolim që prodhonte errësirë e ku përtej errësirës ajo "hante" cdo ditë bijtë e vet. Përtej kësaj nuk kursente dhe bij të tjerë. Ata që kishin mbërritur aty prej besimit tek e njëjta ideologji, ideologjia marksiste që pat ndarë botën më dysh.

Ata ishin nga Kongo. Gjashtë vajza dhe tre djem. Me fatin e brishtë të secilit partia në sistem nuk kursen askënd.

Kujtime të veshura në art, nga vetë karakteri i tyre i brendshëm vështruar jo vetëm si letërsi, ato janë burime dytësore plotësuese për shkrimtarin dhe gjithashtu forma dytësore të zhvillimit letrar të tij. Ndaj duke shfletuar faqet e romanit mbushur me ndodhi emocionuese vërehet qartë se letërsia dhe vërtetësia shpesh paraqiten si faktorë alternativë; ku letërsia rrezikon zbulimin e së vërtetës, ndërsa e vërteta padashur rrezikon deri diku humbjen e vlerës estetike.

Por Fate ja ka dalë mes këtij rreziku të ruajë zbulimin e brendisë njerëzore si dhe të pathënshmet e një kohe aspak të lehtë.

Europa e bashkuar gjithnjë e më shumë po arrin të shkojë drejt rrënjëve të saj historike, ndërsa është në kërkim të një kordoni që lidh kulturën e saj të përbashkët mbi memorien kolektive.

Romani "Mossanga" i Fate Velaj me një subjekt të tillë, aq i debatueshëm në mjediset universitare europiane, është një dëshmi e pastër për këtë. Dhe një Mausoleum i një Shqipërie tjetër.

Nga **Toena**, me përkthimin e  
**Milena Selimit**

## "Kohëstrehim" i Georgi Gospodinov, edhe në shqip



**Georgi Gospodinov** është një nga shkrimtarët më të njohur europianë. Me origjinë nga Bullgaria, romanet e tij kanë fituar dy herë çmimin më prestigjioz letrar të vendit të tij dhe janë përzgjedhur në listën e ngushtë për shumë çmime ndërkombëtare – për Çmimin Letrar PEN për Përkthimin, Premio Gregor von Rezzori, Bruecke Berlin Preis dhe Haus der Kulturen der Welt Literaturpreis –

dhe kanë fituar çmimin Jan Michalski (2016) për Letërsi dhe Çmimin Angelus për Letërsinë e Europës Qendrore (2019), Premio Strega Europeo (2021).


Një 'klinikë për të shkuarën' e drejtuar nga Gaustin, një terapist enigmatic, ofron një trajtim premtues për të sëmurët nga Alzheimer: çdo kat riprodhon një dhjetëvjeçar, duke i transportuar



Georgi Gospodinov

KOHËSTREHIM

Përktheu Milena Selimi



FATE VELAJ

MOSSANGA

OnufriRoman









## FTESE INVITATION

# FESTIVALI LETRAR NDËRKOMBËTAR PËR TË RINJ

"TIRANA GATE" 2024

# INTERNATIONAL YOUTH LITERARY FESTIVAL

"TIRANA GATE" 2024

Njeriu i sotëm / Today's being

**9 - 10 - 11**

Tetor / October 2024

**edicioni i 10<sup>të</sup>**

Salla e koncerteve "Tonin Harapi",  
Liceu Artistik "Jordan Misja"

me pjesëmarrjen e autorëve  
më në zë shqiptarë  
dhe europianë

Ceremonia e çeljes  
9 tetor, ora 10:30

Organizator / Organizer



**10<sup>th</sup> edition**

"Tonin Harapi" concert hall,  
"Jordan Misja" Artistic Lyceum

with the participation  
of the most well-known  
Albanian and European authors

Opening ceremony  
October 9, 10:30

Mbështetës / Supporters



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

